
[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI V - NR. 256 | E ENJTE, 29-10-2015 | www.shqiptarja.com

FLISNIN ME KODE SI NAZISTET, DY SHIJAKSIT LUMENJ DROGE NE ITALI








Skema dhe përgjimet e operacionit "Engima" për zbulimin e gjashtë bazave në Itali. Dy kapot në kërkim arrestohen 16 trafikantë, droga sillej nga Afganistani. Bllokohet kompleksi lukzos i eventeve të miss-eve në Xhafzotaj dhe dy pika karburanti ▸ FAQE 2-3-4

MASTERI

JA KUSH DO TE PAGUAJE DYFISHIN E TARIFES

▸ F 17



DEPUTETI I RI

NDOCAJ SOT NE KUVEND ME MAKINEN E "AL PAÇINOS"

▸ F 11

Kompensimi

SI DO NDAHEN 11 MILIONE DOLLARE PER PRONARET

Artan Lame: 90 mijë banesa rrezikojnë të mos përfshihen në procesin e legalizimeve. Kreu i ALUIZNI-t flet në Kuvend për fondin e kompensimit të ish-pronarëve

▸ FAQE 8

Kufiri me Greqinë, pakt i ri ose arbitrazh



Ministri Bushati flet për bisedimet me fqinjët dhe për votën në OKB: Nuk votuam kundër SHBA

▸ F 12

VIZITA NË SHBA

Meta: Do të ndihmojmë në krizën e refugjatëve


Kryetari i Kuvendit zhvillon takime me kongresmenët amerikanë

▸ F 10

DOSSIER

AKTI I PAVARESISE, ZBULOHEN FAKTE TE REJA PER DOKUMENTIN ORIGJINAL

Për herë të parë fotografia e dokumentit të Pavarësisë, i shkruar dhe i firmosur më 28 nëntor 1912



NGA VASFI BARUTI

▸ F 20-21

"DREJT PUNES"

TAULANT MUKA, MJEKU QE PREKU ENDRREN NE HARVARD

Fjorda Koromani: Ja pse u largova nga Tirana për në Rotterdam

▸ F 13-16



Cyan magenta yellow black

100 POLICË
Mediat italiane shkruajnë se në operacion janë angazhuar rreth 100 forca të policisë gjyqësore të Venecias, por dhe të policisë shqiptare.


Altin Hajri


Emiljan Hajri


Kastriot Rizaj


Hajri Balla


Algen Bushi


Martin Sinani

ANETARET E BANDES

Biseda si nazistët dy shijaksit lumenj me drogë në Itali

Prokurorisë italiane i janë dashur 5 vite hetime për të zbuluar kodet numerike të organizatës



Harta e ndërtuar nga prokuroria italiane, ku tregon trafikimin e drogës nga Afganistani,Turqia, Shqipëria dhe më pas në tregun italian, ku dhe bëhej shpërndarja


ELTON QYNO
TIRANE


Aventura në Itali e dy vëllezërve nga Shijaku, Altin dhe Emiljan Hajri ka nisur fillimisht si emigrantë, duke kryer punë të ndryshme në ndërtim dhe më pas duke shpërndarë doza të vogla droge në zona të ndryshme të Padovës. Por pas disa vitesh, dy vëllezërit nga lagjia e "Çobenëve" në Xhafzotaj të Shijakut, bëhen zotër të një perandorie droge, duke arritur të shpërndajnë brenda një viti gati 1 ton heroinë dhe këtë e bënin në 6 zona të mëdha të Italisë veriore. Të shkathët në lëvizje dhe të vendosur deri në fund për atë që bënin, dy vëllezërit kishin gjetur dhe një mënyrë krejt të veçantë për të mbajtur kontakte me anëtarët e organizatës. Zëri i dy vëllezërve nuk dëgjohej kurrë në telefon, kjo pasi ata përdornin një kod alfanumerik për të komunikuar dhe lëshuar urdhërat tek ushtarët e tyre në Itali. Ata kishin zgjedhur të vinin "ushtrinë" e tyre të shpërndarjes së drogës, njësoj si nazistët që lëviznin ushtrinë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ashtu si ushtria naziste që komunikonte me kode numerike dhe më pas këto numra i përkthente në fjalë, njësoj lëviznin dhe dy vëllezërit Altin dhe Emiljano Hajro. Kjo skemë komunikimi ka futur disa herë në kurth policinë italine, e cila për vite me rradhë nuk arrinte të kuptonte "gjeagjëzën", skemën e veprimit të këtij grupi, megjithëse në periudha të ndryshme arrinte të kapte sasi të konsiderueshme heroine. Nëse një bazë zbulohej, bazat e tjera vepronin të qeta, kjo falë edhe ndryshimit të kodit komunikues. Dhe sërisht puna e agjentëve italianë fillonte nga fillimi për të rënë në gjurmët e grupit. Ky aktivitet kriminal mësohet të ketë filluar që prej vitit 2003, ndërkohë policia italine ka nisur hetimet në 2010 me kapjen e një sasie droge dhe pas 5 vitesh janë arrestuar 22 persona, ndërkohë dy vëllezërit Hajri janë shpallur në kërkim.


Heroina e sekuestruar

Bashkëpunimi
Bashkëpunimi mes dy policive, asaj shqiptare dhe italiane në kuadër të një hetimi i cili nisi disa vjet më parë u konsiderua tepër i frytshëm.


Armando Sherko


Gerald Haxhiaj


Erion Culhaj


Klevis Sena


Gentian Mecollari

TE ARRESTUAR

AMBASADORI I GRUPIT

Fortuz Hajri, i arrestuar në Itali konsiderohet si "ambasadori" i kësaj organizate, pasi ishte atashuar në Itali nga dy vëllezërit Emiljan dhe Altin Hajri, për të komunikuar urdhërat tek drejtuesit e bazave të përpunimit dhe më pas shpërndarjes. Dy vëllezërit qëndronin në Shqipëri, ku i jepnin kodin numerik "Ambasadorit" dhe më pas ky i fundit e kuptonte urdhërin dhe më tej ia dërgonte sërisht me kod numerik drejtuesve të mëposhtëm. Pikërisht pas kësaj baza e narkotrafikut vihej në lëvizje. Kështu veprohej kur vinte droga, ku shpërndahej dhe më pas kur shitej. Po e njëjta skemë veprohej edhe kur shitej me shumicë, tek grupe të tjera kriminale dhe kur transportoheshin lekët me korrierë të ndryshëm nga Italia në drejtim të Shqipërisë, ku pa dyshim personat pritës ishin dy vëllezërit Altin dhe Emiljan Hajri.

ZBULIMI I GJEAGJËZËS

Kjo skemë komunikimi ka futur disa herë në kurth policinë italine, e cila për vite me rradhë nuk arrinte të kuptonte "gjeagjëzën",skemën e veprimit të këtij grupi, megjithëse në disa raste ka kapur sasi të konsiderueshme heroine.

Kthente fjalët në numra

Historia e aparaturës që përdorën Gjermanët gjatë luftës së dytë

"Enigma" ka qenë një aparaturë që shërbente për të koduar dhe dekoduar mesazhe elektro-magnetike me një sistem me rrotëza, që u shpik në fillim të shekullit XX për përdorim tregtar e ushtarak, por famën e fitoi me përdorimin ushtarak. "Enigma" u shpik nga inxhinieri gjerman Arthur Scherbius në fund të Luftës së Parë Botërore. Emri që i është vënë "Enigma" vjen nga greqishtja dhe do të thotë "Gjeagjëzë". Gjatë 1920 kjo aparaturë pati një përdorim tregtar në disa vende, por perfeksionimi i saj u bë nga ushtria e Gjermanisë naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1945). Parimi i funksionimit të saj është që fjalët që shtypen në të ajo i transmeton në shifra të koduara.


Alket Plaku


Ermal Durda


Durim Vishkurti



Sokol Cota


Ardit Kurti


Fisnik Kuci


Shahin Mecollari





Gjashtë bazat në Itali të grupit

Organizata e sillte drogën nga Afganistani dhe shiste në Itali

Elton Qyno
TIRANE

Është cilësuar si një nga hetimet më të rëndësishme të viteve të fundit, ai që zbuloi një trafik të gjerë droge që niste nga Afganistani në Veneto, duke kaluar në Turqi e Shqipëri. Në Itali janë arrestuar 16 persona në sajë të operacionit "Enigma", ndërsa në krye të organizatës ishin dy vëllezër Shqiptarë 30 dhe 28 vjeç Emiljano dhe Altin Hajriu. Më shumë se 450 kilogramë drogë e papërpunuar, 325 kilogramë marijuanë, 206 kilogramë heroinë, dhe 22 urdhër-arreste të lëshuar nga policia italiane. Njëkohësisht janë sekuestruar 5 automjete, si dhe dy laboratorë ku përpunohej droga. Këto janë shifrat rekord të një operacioni të drejtuar nga Guardia di Financa në Itali, në bashkëpunim me policinë shqiptare. Rezultate të arritura falë hetimeve të nisura që në vitin 2010, kur janë sekuestruar 20 kg heroinë në Breshia.

BAZAT NË ITALI


Forcat italiane të rendit kanë zbuluar një organizatë të tërë kriminale që merrej me trafikun ndërkombëtar të drogës, aktive mes Shqipërisë dhe Italisë në zonat e Venetos, Trentino Alto Adige, Emilia Romania, Breshia dhe Umbria. Në Trento ndodhej një bërthamë shpërndarjeje dhe dorëzimi për drogën, si dhe një bërthamë e dytë logjistike, e cila mblidhte paratë dhe i dërgonte në Shqipëri me automjet apo në rrugë ajrore. Më pas në Verona në Roverkiara një grup tjetër merrte, përpunonte dhe shpërndante ngarkesat me heroinë, në fund një strukturë kriminale në Padova kryente lidhjet mes trafikantëve vendas dhe krerëve të organizatës si dhe me shpërndarjen e drogës dhe mbledhjen e parave të fituara nga shitja.

1 TON HEROINË

Organizata merrej sidmos me heroinën, e prodhuar në mënyrë të veçantë në Afganistan dhe e importuar në Europë nëpërmjet itenerarit ballkanik me kamiona e makina të vogla. Një trafik ku Veneto shihej si treg të privilegjuar, pasi është rajoni i dytë në Itali për sekuestrime të këtij lloji. Krerët e organizatave kanë mbërritur në Padova rreth 15 vjet më parë si klandestinë duke u integruar shumë shpejt në dinamikat e shpërndarjes. Më pas kanë drejtuar trafiqe gjithnjë e më të rëndësishme duke arritur të sillnin në Itali deri në një ton drogë në vit si dhe të specializoheshin në trafikun e marijuanës.


Shahin Cara


Fortuz Hajri


Astrit Muca


Makineri për presimin e pakove të heroinës

LISTA E GRUPIT

1.	**Altin**	Hajri	30 vjeç
2.	**Emiljan**	Hajri	28 vjeç
3.	**Kastriot**	Rizaj	34 vjeç
4.	**Hajri**	Balla	52 vjeç
5.	**Algen**	Bushi	32 vjeç
6.	**Martin**	Sinani	32 vjeç
7.	**Alket**	Plaku	38 vjeç
8.	**Ermal**	Dorda	30 vjeç
9.	**Durim**	Vishkurti	35 vjeç
10.	**Sokol**	Cota	39 vjeç.
11.	**Ardit**	Kurti	32 vjeç
12.	**Fisnik**	Kuçi	30 vjeç
13.	**Shahin**	Meçollari	28 vjeç
14.	**Armando**	Sherko	29 vjeç
15.	**Gerald**	Haxhiaj	28 vjeç
16.	**Erion**	Cullhaj	27 vjeç
17.	**Klevis**	Sena	26 vjeç
18.	**Gentian**	Meçollari	31 vjeç
19.	**Shahin**	Cara	
20.	**Fortuz**	Hajri	
21.	**Astrit**	Muça	

76 mijë euro

Gjatë operacionit janë sekuestruar mbi 76 mijë euro dhe 17 mijë franga zvicerane. Një pjesë e parave investohej në pasuri të patundshme ndërsa një pjesë tjetër përdorej për blerjen e drogës.

20 vite burg


Krerët e kësaj organizate rrezikojnë deri në 20 vjet burg. Momentalisht Altin dhe Emiljano Hajriu janë në kërkim policor, pasi në Shqipëri nuk kanë mundur të arrestohen nga policia.

Bllokohet pasuria, organizonin edhe evente për miss-et

Altin Hajri 7 vite tregti edhe me naftën. Dyshime se operacioni u dekonspirua

Elton Qyno
TIRANE

Një pasuri që përllogaritet në 10 milion euro është vënë në masën e sekuestros nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Kjo pasuri zotërohet nga dy vëllezërit Altin dhe Emiljano Hajri, të cilët paratë e fituara nga aktiviteti kriminal i kanë investuar në hoteleri, komplekse eventesh, servise makinash moderne, automjete dhe pasuri të tjera të patundshme si shtëpi etj. E gjithë kjo pasuri tashmë është bllokuar, ndërkohë që dy vëllezërit janë shpallur në kërkim nga ana e policisë shqiptare. Një pjesë e parave që ata fitonin nga trafikimi i drogës është shpenzuar në investime të ndryshme, ndërkohë që pjesa tjetër shkonte për të likujduar personat ku ata e blinin lëndën narkotike, siç ishin Turqit. Në Shqipëri dy vëllezërit kishin ngritur një perandori biznesesh, ku vitet e fundit kishin hapur dhe një kompleks eventesh, duke e emërtuar "Kompleksi Garden" me 10 mijë metra katrorë. Pikërisht në këtë kompleks janë organizohen dasma dhe evente të ndryshme deri në spektakle bukurie. Ndërkohë disa ambjente të kompleksit shërbejnë dhe si lavazhe, dhe bar kafe. Po në Shqipëri janë sekuestruar tre mjete për paketimin e drogës, një furgon, një motorr, dy navigatorë satelitarë, 51 aparate celularë, një thikë.



OKR

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K81714503E
2. Data e Regjistrimit	14/05/2008
3. Emri i Subjektit	ALT-OIL 2008
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	22/04/2008 Deri:
6. Kohëzgjatja	Nga: 22/05/2008 Deri:
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Xhafzotaj PEJZE Fshati Pjezge,Komuna Xhafzotaj,.
8. Kapitali 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100 000,00
9. Objekti i aktivitetit	100,00 Import-eksport,tregtimin me pakicë te karburanteve,lubrifikanteve, lendeve djegese etj.Hoteleri - Restorant etj
10. Administratori/et 10.1 Afati i emërimit	Altin Hajri Nga: 19/11/2012 Deri: 19/11/2017
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	Altin Hajri Natyre:
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100 000,00
12.2 Numri i pjesëve	100,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Durres Xhafzotaj PEJZE Pjeze Fshati Pjezge, Komuna Xhafzotaj, Prane Kompleksit Golden Emri i rrugës: ALT-OIL 2008 SH.P.K. Telefon: 0682069360

TREGTIA ME NAFTËN

Po ashtu njëri nga vëllezërit, në vitin 2008 ka hapur dhe një kompani nafte "Alt Oil 2008" me të cilën ka kryer aktivitet tregtar gjatë këtyre viteve. "Shqiptarja.com" ka mundur të sigurojë faksimilen e bizneseve të Altin Hajris,i cili rezulton pronar në kompaninë e hidrokarbureve "Alt Oil 2008". Sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit kompania e personit të konsideruar "kapo" i grupit të strukturuar kriminal të drogës, operon me seli në Durrës Xhafzotaj pranë Kompleksit "Golden" për të cilin mediat italiane raportojnë se është pronë e vëllezërve Hajri. Po sipas QKR-së kjo kompani me pronar Altin Hajrin ka si aktivitet të sajin import-eksport, tregtimin me pakicë të karburanteve lubrifikanteve, lëndëve djegëse etj,si dhe Hoteleri-Restorant etj. Aktivitetin tregtar Hajri e ka nisur në 14 maj të 2008-ës ndërsa rezulton pronar i kompanisë së hidrokarbureve me 100 % të aksioneve. Nga trafiku i drogës sipas Guardia di Finanzës dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, 22 anëtarët e kësaj organizate në një vit arrinin të qarkullonin miliona euro drogë.

DEKONSPIRIMI I OPERACIONIT

Largimi para kohe e dy vllezërve Hajri, ka sjellë mos arrestimin e tyre nga ana e policisë Shqiptare. Dy vllezërit që cilësohet si drejtuesit e këtij grupi ende vijojnë të jenë në kërkim, ndërkohë që ata nuk kanë qënë të panjohur nga policia e Durrësit. Kjo pasi njëri nga vllezërit Altin Hajri është bërë disa herë protagonist i disa ngjarve kriminale, nga të cilat ka përfunduar në qelitë e shoqërimit në komisariatin e Durrësit. Ajo që tashmë ka ngritur dyshime të forta është se operacioni policor për kapjen e tyre është dekonspiruar. Gjatë ditës së djeshme në Durrës janë arrestuar vetëm Klevis Sina dhe Gention Meçollari.Ndërkohë policia ka kryer disa kontrolle në banesa por nuk ka gjetur asnjë gjurmë të dy vllezërve Altin dhe Emiljano Hajri.





Godina e kompleksit Garden në Xhafzotaj në Durrës. *(mjitas)* Faksimile e ekstraktit të QKR për kompaninë e naftës së Altin Hajrit

MJETET PËR DROGËN

Po nga autorietet shqiptare janë sekuestruar në Durrës tre mjete për paketimin e drogës, një furgon, një motorr, dy navigatorë satelitarë, 51 aparate celularë, një thikë.

ME NAFTËN

Aktivitetin tregtar Hajri e ka nisur në 14 maj të 2008-ës ndërsa rezulton pronar i kompanisë së hidrokarbureve me 100 % të aksioneve. Ky aktivitet vijon të jetë ende aktiv.

HISTORIA/ PINTE UISKI ME FEMRA, HAJRI SHERR NE LOKAL

Kapoja i drogës,u dënua me 2.6 mln lekë për fyerje të policisë

Njëri nga kapot e organizatës kriminale Altin Hajri ka qenë mjaft i njohur për policinë e Durrësit, kjo pasi është implikuar në disa ngjarje kriminale, për të cilat dhe është marrë i pandehur. Disa vite më parë Altin Hajri është dënuar me 2.6 milion lek pasi është marrë i pandehur nga prokuroria e Durrësit për akuzën e "Kundërshtimit me forcë të forcave të rendit", "Fyerjes së punonjësve të policisë" dhe "Prishjes së qetësisë publike".Në 6 mars 2010 Altin Hajri rreth orës 21:30, bashkë me një shokun e tij, shtetasin Dritan Turja ka shkuar në lokal "Portsaid" në Durrës. I pandehuri në lokal është takuar edhe me dy vajza dhe kanë konsumuar pije alkolike "Xhek". Më pas, i pandehuri Altin Hajri bashkë me shtetasin Dritan Turja dhe dy vajzat janë çuar për të dalë nga lokali.Në këtë kohë ai është konfliktuar me disa persona të tjerë,djem që ndodheshin në lokal dhe në lokal është krijuar rrëmujë. Për të neutralizuar konfliktin kanë ndërhyrë persona të tjerë dhe i kanë ndarë. Te lokali kanë shkuar punonjësit e policisë Arnald Ismaili, Avni Kokomani. Aleks Kalemi etj,që kanë kërkuar ndihmën e grupit të gatshëm, i përbërë nga punonjësit e policisë Hysen Gashi, Altin Hoti dhe Enver Boshnjaku. Ka rezultuar që tek lokali "Portsaid" në lagjen Nr.1 të qytetit Durrës, ka shkuar dhe grupi i gatshëm i policisë për të sqaruar rrethanat e konfliktit dhe për të shoqëruar personat përgjegjës. Punonjësi i policisë Hysen Gashi i është afruar të pandehurit Altin Hajri dhe i ka kërkuar që të shkonte me ta në polici,për të sqaruar shkaqet e konflikt. I pandehuri Altin Hajri që ishte i dëmtuar në hundë gjatë konfliktit të ndodhur,ka kundërshtuar policët që ishin duke kryer detyrën.Ai i ka sharë dhe fyer punonjësit e policisë Hysen Gashi,Altin Hoti,Enver Boshnjaku dhe punonjësit e tjerë të policisë që ndodheshin në vendin e konfliktit.Në këto rrethana ka ndërhyrë punonjësi i policisë Hysen Gashi,që e ka kapur për krahu të pandehurin,duke i thënë që duhet të shkonte në Komisariat.

FYERJET PER POLICET

Në hetim del se edhe gjatë shoqërimit në polici,në automjetin e policisë,i pandehuri Altin Hajri ka vazhduar të shajë,fyejë dhe ofendojë punonjësit e policisë së rendit publik.



Altin Hajri

"Bajrami m'u prezantua si shoqërues i një deputeti"

Giorgio Rifformato ngre alibinë: Do hapja zyrë turizmi në Shqipëri. Kishte kërkesa me rastin e ardhjes së Papës

Piloti i avionit të drogës së rrëzuar në Divjakë rreth një vit më parë, Giorgio Rifformato, ka deklaruar dje në gjykatë se kishte vendosur të vinte në Shqipëri duke parë kërkesat e shumta për turizëm. Madje duke kundërshtuar deklarimet e dëshmitarëve të mëparshëm në proces, Rifformato është shprehur se nuk ishte i përfshirë në trafik droge, madje dhe për defektin që i pësoi avioni kishte dhënë alarmin SOS. "Saimir Bajrami më është prezantuar si polic e më pas si shoqërues i një deputeti shqiptar, emrin e të cilit s'ma tha kurrë". Me këtë dëshmi piloti italian Giorgio Rifformato nën akuzë për avionin e drogës në Divjakë mohoi të kish dijeni për trafikun e drogës apo njohje të mëparshme me shqiptarët e arrestuar mes tyre dhe Bajramin. "Me një distinktiv policie Saimir Bajrami mu afrua teksa po pija kafen pranë një lokali në dalje të aeroportit, aty mu prezantua si polic dhe shoqërues i një deputeti shqiptar. Emrin e të cilit nuk ma tha, Bajramin se kam njohur kurrë më parë, dhe e kam takuar më 8 maj në Rinas dhe më ka shoqëruar së bashku me dy persona të tjerë nëpër Tiranë dhe deri tek hoteli pranë prokurorisë së përgjithshme ku kam qëndruar 2 ditë", - me këtë dëshmi piloti italian i avionit të Divjakës Girogo Rifformato mohoi të ketë njohje me Saimir Bajramin apo të ketë thurur me të një plan për trafik droge. Pyetjeve të prokurores Elisabeta Imeraj se përse kishte ardhur në Shqipëri dhe si përfundoi në plazhin e Divjakës, ai ju përgjigj duke sqaruar: "Në Shqipëri vendosa të vij për turizëm dhe për të parë mundësinë e një investimi duke hapur një agjenci turistike. 2014 ishte viti kur në Shqipëri do të vinte Papa dhe në atë periudhë kompania ime Fox Jet kishte shumë kërkesa për të sjell turist në Shqipëri. Më 10 Maj kur lashë aeroportin e Rinasit dhe po vizitoja bregdetin shqiptar, pësova një defekt teknik për shkak të një turbulence ajrore, lëshova alarmin SOS alarm të cilin kulla ajrore e Brindisit e ka kapur dhe ajo e Tiranës jo". Dëshmia e Rifformatos vjen për herë të parë pas arrestimit të tij 18 muaj më parë në plazhin e Divjakës nën akuzën e trafikut ndërkombëtar të drogës të mbetur në tentative. Në këtë proces gjykata vendosi t'i jap fund seancave të dëshmive dhe më 5 nëntor të administroj provat, ndërsa Rifformato i pranishëm në seancë kërkoi lirinë duke argumentuar se faji i tij i vetëm ishte se u prish avioni dhe u rrëzua në Shqipëri.


Giorgio Rifformato

Prezantimi
Me një distinktiv policie Saimir Bajrami mu afrua teksa po pija kafen pranë një lokali në dalje të aeroportit, aty mu prezantua si polic dhe shoqërues i një deputeti shqiptar, emrin e të cilit nuk ma tha

Argumenti

Përballja e dëshmimtarëve në gjykatë gjatë procesit


Saimir Bajrami

Dëshmitarët e paraqitur tre javë më parë në procesin e nisur në Gjykatën e krimeve të Rënda kanë rrëzuar alibinë e italianit, se kishte ardhur në Shqipëri për turizëm, dhe se kishte bërë ulje të detyrueshme në plazhin e Divjakës. I pari ka dëshmuar një punonjës i aeroportit të Rinasit, i cili kishte shoqëruar të pandehurin në momentin e mbërritjes. Eduart Panariti deklaroi në gjykatë se nga kontrolli i bërë avionit nuk ishte konstatuar asnjë defekt. Ndërsa dëshmitari tjetër ishte Erjon Rrushi një i afërm i të pandehurit tjetër Sajmir Bajrami, për te cilin Riformato tha se nuk kishte njohje. Ai ka deklaruar se me porosi të Bajrami e kishte shoqëruar Riformaton nga aeroporti i Rinasit në një hotel në Tiranë ku kishte ngrënë një darkë dhe më pas e kishte çuar në Durrës. Rënia e avionit "Piper" në plazhin e Divjakës ndodhi në datën 10 maj të vitit të kalua. Pranë avionit u gjetën 460 kilogramë hashash, ngarkuar në një automjet tip "Mitsubishi". Pas operacionit të policisë, u bë e mundur dhe arrestimi i drejtuesit të mjetit, përkatësisht Saimir Bajrami, 35 vjeç, te cilit i janë sekuestruar dhe 27 mijë euro dhe më pas në pranga u vu edhe shtetasi italian, i cili e ka mohuar përfshirjen në trafikun e drogës.

Në Shqipëri vendosa të vij për turizëm dhe për të parë mundësinë e një investimi duke hapur një agjenci turistike

LAJME SHKURT

Shqiptarët përleshen në burg me amerikano-jugorët, 20 të plagosur

20 të dënuar në burgun e Marassisë në Genova të Italisë, kanë mbetur të plagosur gjatë një përleshjeje fizike mes një grupi shqiptar dhe një amerikano-jugor. Të burgosurit, të armatosur me thika, janë përplasur rreth orës 13.00 të së mërkurës, gjatë momentit të ajrimit. Vetëm me ndërhyrjen e policëve të burgut është bërë e mundur vendosja e situatës nën kontroll. Autoritete e burgut e kanë cilësuar situatën si të paqëndrueshme dhe kanë bërë thirrje që qeveria të marrë masa. Të plagosurit janë dërguar në spital për të marrë ndihmën mjekësore, ndërkohë që nuk dihen ende shkaqet e konfliktit.



SHPALLJE ANKANDI

Shoqeria Permbarimore "616/A" shpk, shpall shitjen ne ankand per pasurine " Truall + Ndertese ", me sip. 350 m2, nga te cilat 350 m2 truall dhe 180 m2 ndertese, me numer pasurie 584 / 7 , vol. 23, fq. 33, zk. 2697, me adrese fshati Miras, Devoll.

Pasuria nxiret ne ankand me vleren fillestare 1.120.000 (njemilion e njeqind e njezetmije) Leke.

Ankandi Zhvillohet ne daten 26.11.2015.

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjia nr.3, Rruga "Naim Frasheri", Pogradec ose te kontaktojne ne numrin 0697251504 ose ne e-mail: shoqeria616a@gmail.com



Lokal pa licencë brenda burgut të Shënkollit, pranga 27-vjeçarit

Një 27 vjeçar nga Shëngjini është arrestuar këtë të mërkurë nga policia e Lezhës, pasi ushtronte një aktivitet tregtar pa licencë dhe të paregjistruar në organet tatimore në ambientet e një burgu. Sipas policisë, i arrestuari Saimir Zeneli, kishte hapur një lokal "bar-kafe" në ambjentet e brendshme të burgut të Shënkollit në Lezhë, që ka rezultuar pa licensë dhe i paregjistruar. 27 vjeçari i arrestuar do të hetohet për veprën penale "fshehje e të ardhurave", parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

Padia, Dhima-At Nikollës: "Prift mashtrues që përdhos fenë"

Zëdhënësi i Kishës Ortodokse, Thoma Dhima, i është përgjigjur në Facebook, 12 akuzave me të cilat At Nikoll Marku, prift në Kishën Ortodokse të Elbasanit, tha se do t'i drejtohej Prokurorisë kundër Kryepeshkopit, Anastas Janullatos. Dhima ironizon duke shkruar se një "kirurg" i vetëshpallur i një universiteti që nuk ekziston nuk mund të mashtroje njerëzit. Ai i referohet kështu pretendimeve të At Nikolla Markut, i cili e ka shpallur veten drejtues të "Kishës Kombëtare Autoqefale Orthodhodokse të Shqipërisë". Dhima sqaron se ky është një institucion fantazmë. Sipas tij, At Nikoll Marku "po përdhos fenë e krishterë".





Fushë Krujë-Milot, e përplas furgoni, humb jetën 60 vjeçari

Një aksident i ndoshur në rrugën Fushë Krujë-Milot i ka marrë jetën një këmbësori, i cili po kalonte rrugën. Viktimë e aksidentit ka mbetur 60 vjeçari Ramazan Kukici, nga fshati Gjorm i Kurbinit. Mësohet se vikëtima u përplas nga një furgon mallrash me targë AA 350 CG, i cili drejtohej nga Mentor Rama. Kukici është dërguar me urgjencë drejt spitalit, por nuk ka mundur të mbijetojë si pasojë e plagëve të marra. Efektivët e policisë kanë ndaluar shoferin e fugonit në vendin e ngjarjes. Ndërkohë, po vijojnë hetimet për të zbardhur rrethanat e plota të këtij aksidenti.

Berat, makina përplas motoçikletën, humb jetën 41 vjeçari

Një 41 vjeçar ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti autobolistik. Ngjarja ka ndodhur në aksin rrugor Urë Vajgurore-Berat, në vendin e quajtur Orizaj. Mësohet se 24 vjeçari Eni Bregu, duke drejtuar automjetin tip "Benz" me targa AA 258 Hl, ka goditur motorrin tip "Kavasaki", që drejtohej nga 41-vjeçari L.C, banues në Berat. Ky i fundit ka ndërruar jetë në spital si pasojë e plagëve të marra. Policia ka arrestuar drejtuesin e makinës tip "Benz", Eni Bregu. Materialet i kaluan Prokurorisë së Beratit për veprat penale "Shkelja e regullave të qakullimit rrugor" dhe "Largimi nga vendi i aksidentit".

& Pyetje Përgjigje


Demonstrata e 21 Janarit

Vrasjet e 21 janarit 'ngecin' në gjykatë, do pyetet Berisha?!

Dy vite në pritje, Gjykata e Lartë nuk cakton datën e gjyqit. Vrasja e Aleks Nikës mund të rikthejë çështjen

Vrasjet e 21 janarit të 2011 në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" përpara kryeministrisë janë plaga më e madhe e viteve të fundit që nuk po gjen zgjidhje. Me gjithë premtimet e qeverisë së majtë në pushtet, 4 të vrarët nga armët e Gardës, që po protestonin kundër qeverisë Berisha, megjithëse ishin me duar në xhepa dhe protesta po shpërndahej, ende bëjnë apel për drejtësi. Ndërkohë që për Aleks Nikën ende s'kanë përfunduar hetimet e është vrasje pa autor, ndërsa pritet ndoshta dhe një "trimërim" i Llallës për të thirrur Berishën si person që ka dijeni përderisa zbardhi skenarin me çadra pistoletë dhe thika me helm dhe për ta pyetur, për Ziver Veizin, Hekuran Dedën e Faik Myrtajn janë dënuar fajtorët Ndrea Prendi e Agim Llupo, pa marrë parasysh ekspertizën e FBI që pritet të rivitalizohet tashmë që 3 ekspertë janë këtu. Ndërsa Gjykata e Lartë ka "harruar" për 2 vite dosjen 21 janari.

Dosja e 21 janarit ku u vranë katër demonstrues të pafajshëm të opozitës ka ngecur këtu e dy vite në Gjykatën e Lartë dhe askush nuk denjon ta prekë. Po përgatitet pushimi i çështjes...?

Dosja e "21 Janarit", dje mbushi plot dy vite që është hedhur në short dhe ende nuk dihet asgjë për fatin e saj. Me gjithë kohën që ka kaluar, por edhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje të lidhur me demonstratën e 21 janarit, ku mbetën të vrarë 4 demonstrues, Gjykata e Lartë s'ka caktuar ende një datë për të çelur procesin gjyqësor. Burimet bëjnë me dije se dosja me të pandehurit ish-komandantin e Gardës Ndrea Prendi, ish-shoferin e tij Margarit Kume, dhe ish-komandantin e njësisë speciale Agim Llupo, ndodhet në dhomë këshillimi, që do thotë se prej 28 tetor 2013, gjyqtarët e Kolegjit Penal që janë përcaktuar me short, ende po mendohen se çdo bëjnë me këtë çështje, do caktojnë një datë për të shqyrtuar rekursin e Prokurorisë, apo s'do ta kalojnë fare për gjykim.



Cilët janë gjyqtarët që e kanë në dorë dosjen e "21 janarit"...?

Kjo dosje e nxehtë, është në dorë të relatorit të saj Edmond Islamaj, dhe anëtarëve Guxim Zenelaj, Tom Ndrea, Artan Zeneli dhe Shkëlzen Selimi. Zyrtarisht kreu i Gjykatës së Lartë Xhezair Zaganjori deklaroi në shkurt 2015 se dosja do të gjykohet brenda 6 muajve, por mesa duket kjo deklaratë e kryetarit nuk u mor parasysh nga trupa gjyqësore, që ka kompetencat për të vendosur mbi datat e gjykimit të dosjes. Ish-komandanti i Gardës Ndrea Prendi u dënua me një vit burgim për akuzën e "vrasjes nga pakujdesia" të demonstruesit Faik Myrtaj, ndërkohë që Agim Llupo u dënua me 3 vite për të njëjtën akuzë, për vrasjen e Ziver Veizit. Për të dyja shkallët e gjyqësorit, Prokuroria nuk mundi të bindte se zyrtarët e Gardës i kishin vrarë ata me dashje të drejtpërdrejtë, pasi nuk arriti të sjellë dot një motiv. Po ashtu, për plagosjen e shumë të tjerëve, gjykatat u shprehën se nuk u gjetën predha të qitura nga armët e tyre. Ndërkohë që kanë mbetur pa autorë e Prokuroria nuk ka gjetur ende që nga 21 janari i 2011-s, se kush janë të dyshuarit e vrasjes së demonstruesve Hekuran Deda e Aleks Nika. Duke e zhytur këtë çështje në mister.

Çfarë ndodhi konkretisht më 21 janar, dhe si reagoi shteti?

Opozita paralajmëroi një protestë të madhe në bulevardin qendror të kryeqytetit kundër qeverisë Berisha. Më 21 janar u protestua, pati konfrontime, dhe në momentin kur turma po shpërndahej, Garda qëlloi mbi ata që kishin mbetur, duke lënë të vrarë njëri pas tjetrit, në vende të ndryshme protestuesit Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda që ishte afër gazetarit Fatos Mahmutaj, që u plagos në dorë e tani është në azil politik si dhe më larg akoma Aleks Nikën. Në fillim Berisha reagoi duke thënë se ishte skenar nga 'horri i bulevardit' për presidentin Topi, cilësoi 'lavire bulevardi' ish-kryeprokuroren Ina Rama, akuzoi opozitën se kishte bërë skenar për grusht shteti me çadra pistoletë, thika me helm e se demonstruesit ishin vrarë nga afër nga opozita. Madje kërcënoi se për prekjen e institucioneve do vriteshin dhe 300 demonstrues. Nga ana tjetër nuk lejoi asnjë ekspertim, të plagosurit nga Garda qëndruan brenda rrethimit të kryeministrisë, u mblodhën gëzhojat ndërsa komandanti i gardës Prendi u shfaq me sy të mavijosur, u akuza opozita, por thuhet se u godit nga badigardi i Berishës.

Po prokuroria si veproi...?

Prokuroria lëshoi 6 urdhërarreste, por Berisha urdhëroi kreun e policisë Burgaj të mos i zbatonte, duke e argumentuar më pas se Ina Rama kërkoi arrestimin e zinxhirit komandues të Gardës në kulmin e tentativës për grusht shteti. Urdhrat që në atë kohë u refuzuan të zbatohen e që hapën një luftë të paprecedentë mes dy institucioneve, aq sa ish-Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama, në daljen e saj publike dy-tri ditë pas demonstratës, jo vetëm që bëri apel për ekspertizë drejtuar SHBA, por pranoi se ekzekutimi i urdhër-ndalimeve do kishte ndihmuar për hetimet. Lufta mes Prokurorisë dhe Policisë në atë kohë zgjati rreth dy javë, kur gardistët, mes tyre edhe ish-komandanti i Gardës, Ndrea Prendi, u vetëdorëzuan në Policinë e Tiranës. Po atëherë ishin bërë të gjitha "pastrimet" e vendit të ngjarjes që nga heqja e gëzhojave, serverëve e kamerave të sigurisë, duke fshehur skenën e vrasjeve.

Ndërkohë ishte ekspertiza e FBI që përcaktoi se nga kush ishte vrarë Faik Myrtaj...?

Pas kërkesës së ish-kryeprokurores Ina Rama, FBI dërgoi urgjent rezultatin e ekspertizës së kamerave të sigurisë dhe serverëve ku u vërtetua se ato janë fshirë. Nga ana tjetër ekspertiza e Byrosë Federale të Hetimit (FBI), zbuloi se nga pistoleta personale e llojit "BERETA" që kishte në përdorim Prendi ka gjetur vdekjen fieraku Faik Myrtaj. Gjithashtu përveç plumbit që i solli vdekjen Myrtajt, Prendi ka qëlluar edhe 10 plumba te tjerë në drejtim të demonstruesve. Ndërsa vetë Llupo ka qëlluar me 13 plumba luftarak në drejtim të demonstruesve para ndërtesës së kryeministrisë, duke vrarë dy protestuesit e tjerë. Kurse për Aleks Nikën nuk është përcaktuar asnjë autor dhe çështja është e hapur. Margarit Kume i njohur si ish-shoferi i komandantit Prendi, i akuzuar për fshehjen e provave, pasi kishte ndërruar tytën e pistoletës së Prendit me pistoletën e tij janë tërhequr akuzat nga prokuroria.

Prokuroria në fillim të vitit ka kërkuar rishikimin e provave të gardistëve për rihapjen e dosjes "21 janari". Sa ka mundësi të thirret Berisha me cilësinë e personit që ka dijeni...?

Familjarët e viktimave janë të zhgënjyer nga pritja, ndërsa akuza e Gjykata e Lartë kërkojnë ende kohë për t'u dhënë drejtim çështjeve. Ata kërcënojnë me dërgimin e dosjes në gjykatën e Strasburgut. Nga të 4 viktimat e 21 janarit vetëm vrasja e Aleks Nikës është ende e pazbardhur dhe po hetohet në Prokurorinë e Tiranës, gjë që ngjall shpresat e rikthimit të çështjes. Ndërsa në muajt e parë të këtij viti kryeprokurori Adriatik Llalla ka mbledhur grupin hetimor të Policisë, ku pjesëmarrës ishte vetë Llalla, kreu i policisë së Tiranës atëherë Ardian Çipa, prokurori Petrit Fusha, drejtori i Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme Adnand Xholi si dhe drejtori i Krimeve të Rëndа në Policinë e Shtetit. Qëllimi i kësaj analize është rishikimi i provave dhe dëshmive të gardistëve që janë pyetur lidhur me ngjarjen e 21 janarit 2011 e më konkretisht vrasjen e shtetasit Aleks Nika nga Lezha. Ndërkohë burimet brenda prokurorisë bëjnë me dije se nuk përjashtohet mundësia që të thirret dhe ish-kryeministri Sali Berisha për të dëshmuar me cilësinë e personit që ka dijeni, referuar dhe akuzave të tij se ishte skenar grushti shteti.

BERISHA

Burimet brenda prokurorisë bëjnë me dije se nuk përjashtohet mundësia që të thirret dhe ish-kryeministri Sali Berisha për të dëshmuar me cilësinë e personit që ka dijeni, referuar dhe akuzave të tij se ishte skenar grushti shteti nga ana e opozitës.

BLLOKIMI

Dosja me të pandehurit ish-komandantin e Gardës Prendi, ish-shoferin e tij Kume, e ish-komandantin Llupo, ndodhet në dhomë këshillimi. 2 vjet që gjyqtarët po mendohen, të caktojnë një datë për të shqyrtuar rekursin e Prokurorisë, apo të mbyllin gjykimin.

STRASBURGU

Familjarët e viktimave janë të zhgënjyer nga pritja, ndërsa akuza e Gjykata e Lartë kërkojnë ende kohë për t'u dhënë drejtim çështjeve. Ata kërcënojnë me dërgimin e dosjes në Strasburg.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE
"KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k
NJOFTIM PËR SHITJE NË ANKAND

Më 09.11.2015, në ora 16:00 (të Mërkuren), zhvillohet ankandi i parë për shitjen e kolaterialit të "FONDI BESA".sha për një kredi të pakthyer:

Kolaterali është:

- Zona kad:3699; Numër Pasurie:236/1; FAQE: 247; VOL: 4; RRETHI: Tiranë; Lloji i pronës: Arë me sipërfaqe totale 6000 m2, Adresa: Fushas, Tirane ne pronesi te Shaqir Hasan Rama.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 1,104,000 (një milion e njëqind e katër mijë) lekë.

Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 26.10.2015 deri në datë 09.11.2015 dhe zhvillohet në këtë datë në përfundim të orarit zyrtar (ora 16:00).

Afati i fundit per pranimin e ofertave do të jetë data 09.11.2015, ora 16:00 në ambjentet e Shoqerisë "KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k, me adresë: Rruga "Frederik Shiroka", Kulla 3, Shkalla 3, Zyra 4, Tiranë.

E-mail: info@kodrabailiff.com **Tel:** +355 69 9381888

Adem Vila: Laguna blu u miratua prej Meksit, toka s'shitet

"Privatizohet vetëm trualli me ndërtime, sipërfaqa sportive i përket komuniteti"

Driçim Çaka
TIRANE

"Laguna blu", rezulton të jetë nga fshatrat turistik të parë për të cilat është dhënë leje zhvillimi në vend. Adem Vila, fituesi i koncesionit të zhvillimit të zonës, në një intervistë për "Shqiptarja.com", deklaron se procesi i marrjes së lejes ka nisur që në vitin 1995, ku është shpallur zonë zhvillim për 11.8 hektarë tokë, nga të cilat vetëm 2.8 hektarë do të ishin për ndërtime. Sipas Vilës, pas marrjes së lejes është firmosur një marrëveshje me kompaninë "Epidam" për realizimin e ndërtimeve. Por sqaron se askush nuk ka të drejtën që të shesë truallin jashtë sipërfaqes së parashikuar për ndërtime. Madje Vila nënvizon se dhe ai nuk mund të shesë truallin, pasi leja e zhvillimit është e saktësuar. Në lidhje me miratimin e planit të ri urbanistik të Golemit, Vila shton se ky plan nuk prek kufirin e miratuar për "Laguna Blu".

Z. Vila si ka nisur historia e ndërtimit të fshatit turistik, kur është nënshkruar marrëveshja për zhvillimin e zonës.

Marrëveshja është bërë nëpërmjet meje dhe ministrisë së Turizmit. Në vitin 1995 u shpall zona për zhvillimin e turizmit. Bëra një kërkesë, në bashkinë e Kavajës në bazë të kërkesave që kishin ata. Më pas i dërguan shkresat në ministrinë e turizmit më pas morëm lejen e ndërtimit dhe pastaj procedurat.

A ka specifika se si do të zhvillohet zona?

Në kontrat janë 2.8 hektarë që lejohet të ndërtohet. Janë rreth 250 apartamente, të cilat kanë përfunduar. Është përfunduar dhe objekti pishinës si dhe ambientet sportive. Janë 9 hektarë zonë pyjore që nuk lejohet të ndërtohet. Vetëm zona sportive, mbi të cilën kërkohet të ndërtohet, është afërsisht një hektarë.

Pak vite më parë janë miratuar disa vendime për privatizimet e trojeve turistike?

Privatizimi është vetëm për tokën ku janë objektet e banimit. Por jashtë tyre nuk mund të shitet toka. Pjesa tjetër e sipërfaqes, pra jashtë 2.8 hektarë e parashikuar për ndërtime, nuk mund të shitet. Sipërfaqa tjetër u mbetet të gjithë pronarëve.Ajo që thuhet është se toka është shitur pas vitit 2005. Por unë nga viti 2005 unë nuk komunikoj me ortakun tim në ndërtimin e fshatit, me të cilin kam pasur marrëveshje për ndërtimin e objekteve dhe jo për shitjen e tyre. Dhe tashmë jemi me një proces gjyqësor.

Në vitin 2013 rezulton se është bërë një rishikim i planit urbanistik të Golemit. A është prekur kjo zonë?

Nuk është prekur fare zona, por është vetëm ky rasti i fundit që po prishen ato terrenet.

Mbas 2013 ju jeni në një situatë ku është një konflikt për ndërtim të ri në territrin aktual. Pala tjetër pretendon se është një objekt studim dhe ka leje për këtë pjesë. Keni informacion?

Aty është tokë shteti, nuk shitet, sepse toka që shitet është vetëm 2.8 hektarë që janë ndërtuar godinat që banojnë njerëzit sot. Kurse pjesa tjetër nuk shitet. As unë që kam lejen e zhvillimti nuk mund ta shes. Edhe për këtë kemi mbështetjen e të gjithë komunitetit, sepse këto fusha sporti janë të tyre.

Gjithë protesta është zhvilluar nga një bord drejtues, por nuk ka emra, pse nuk ka emra?

Është i çuditshëm ky fakt ku bordi drejtues nuk shfaqet se kush është. Jo ne kemi dalë me emra edhe ne televizion, përfshirë edhe administratorin.

Edhe zoti Frangaj në këtë rast është një nga banorët?

Një nga banorët, thjesht banor fshati. Por nuk ka të drejtë ai tek pjesa. Sepse këta kanë hapur fjalë sikur e kanë blerë tokën dhe më ofruan mua disa benefite që unë si pranova

Cilat janë benefitet?

Më ofruan që do të japim një shtëpi do të bëjmë fusha të reja do të bëjmë një lokal të mirë e shumë gjëra të tjera. Unë nuk i pranova sepse nuk kam pse i pranoj, sepse ajo është e komunitetit, edhe unë jam banor i atij fshati.

Oferta për zhvillimin e ri ju erdhi në bazë të shkresave konkrete apo...

Jo jo erdhi në mënyrë private. Megjithatë ai nguli këmbë.

A ka një qëndrim bashkia ose komuna?

Dje kur është bërë protesta, kryetari i bashkisë ka thënë që unë s'kam dhënë lejë ndërtimi. Gjithë fshati dhe bordi drejtues kanë çuar peticion Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm, Prokurorit, Bashkisë së Kavajës edhe ALUIZNIT

Përse jeni në gjyq me ortakun tjetër?

Me ortakun tim, kam kaq vite, pasi kam për të marrë një sasi lekësh dhe këtu ka hyrë ky zotëria duke i thënë mos i mbaro punë Ademit. Ato terrene u përket rreth 200 familjeve që banojnë. Dhe u kanë thënë fusha e sportit është e juaja, pishina e juaja.

Leja zhvillimore është firmosur nga qeveria?


Nga Kryeministri Meksi, nga Dashamir Shehi, që ishte zëvendëskryetari i këshillit të ministrave dhe ministri i ALUIZNIT.

KREU I ALUIZNI-it

Artan Lame: Ndryshimi i planit urbanistik të zonës krim i Berishës

Debati për ndërtime të reja në fshatin turistik "Laguna Blu" në Kavajë është zhvilluar dje dhe në komisionin parlamentar të veprimtarisë prodhuese. Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame është shprehur në komision se dhënia e lejes për ndërtime në zonë është një tjetër krim i qeverisë Berisha. "Çështja e Lagunës Blu, është një tjetër krim i qeverisë Berisha në ditët e agonisë së saj. Që do të thotë, se në maj të vitit 2013, në kulmin e agonisë së Qeverisë Berisha, në kulmin e fushatës elektorale, gjeti kohë të miratonte një plan urbanistik, për Golemin, një zonë që e kishte planin urbanistik, i cili funksionon te prej dhjete vitesh, mbi të cilin ishin dhënë lejet e ndërtimit, ishte ndërtuar fshtrat turistikë, ishin ndërtuar pallatet, zonat e stimuluara, po ndërtoheshin rrugët e kështu me radhë, në mes të kësaj situate, në kulmin e fushatës elektorale, në maj të vitit 2013, bënë një plan të ri. Plan që jo vetëm futi në kaos zonën e Golemit, por shtoi edhe zona të reja të reja ndërtimi brenda zonave të gjelbra.


Adem Vila


KONTRATE
PER MBESHTJE SIPERFAQE PYJORE NE PERDORIM
PER QELLIME TURISTIKE.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E NDERTIMIT DHE E TURIZMIT

VENDIM
Nr. 10 date 13.06.1995
I KOMITETIT TE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT

Komiteti i Zhvillimit te Turizmit i krijuar ne baze te Ligjit Nr. 7665 te Kuvendit Popullor date 21.01.1993 , ne mbledhjen e tij te date 13.06.1995 , pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Ministria e Ndertimit dhe Turizmit

VENDOSI:

Te miratoje kerkesen e paraqitur nga Adem Vila per ndertimin e nje fshati turistik ne parcelen Nr. 17 te studimit urbanistik te Golemit , per ushtrimin e " veprimtarise se stimuluar " si dhe ti jape titullin " porton i stimuluar " duke kerkuar plotesimin e kerkesave te meposhtme :
1- Parashtjen e planit te plote urbanistik , planit te infrastruktures dhe projektin ekzekutiv brenda dates 13.09.1995.
2- Te zgjidhet problemi i mbeturinave urbane me qellim mosndotjen e ambientit.
3- Te parashikohet rrethinni dekorativ i zones.
4- Adem Vila dubet te firmose dhe parapse me shkrim deklaraten ne Ministrine e Ndertimit dhe Turizmit se pranon Vendimin Nr. 10 date 13.06.1995 te Komitetit te Zhvillimit te Turizmit se pranon Vendimin Nr. 10 date 13.06.1995 te proj tij.

KRYETARI I KOMITETIT TE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT
EDMOND SPAHO

REAGOJNE PRONARET / GUGA: NUK DO SHUME TE KUPTOSH MANIPULIMET

Frangaj: Tokën e kam blerë nga "Epidam", kam leje

Në një reagim për banorët, Aleksandër Frangaj ka deklaruar se ka leje për zhvillimin e ndërtimeve në zonën e njohur si Laguna Blu. Madje, ai shton se ia ka blerë truallin mbi të cilin do të bëjë ndërtimin kompanisë "Epidam". "Ish fushat sportive nuk kanë qenë kurrë sipërfaqe të përbashkëta, por kanë qenë investim, pronë dhe janë administruar nga kompania Epidam. Në fillimet e veta ata që kanë luajtuar aty, kanë paguar qira për çdo lojë në to siç paguajnë për të hyrë tek pishina sot. Asnjë banor i fshatit nuk ka paguar as edhe 1 euro për atë investim. Ato ambiente janë shitur tek unë nga kompania Epidam, siç kjo kompani ka shitur secilën nga vilat, apartamentet apo bar


Aleksandër Frangaj

restorant pishinën, duke qenë investitore dhe ndërtuese e gjithë objekteve të laguna blu. Prona është blerë nga ana ime në baze të të gjithë ligjeve të këtij shteti prej shitësit të ligjshëm dhe është e hipotekuar", shprehet Frangaj. Ndërsa shton se dhe leja e ndërtimit është bnë bazë të studimit të komunës Golem. "Me të drejtën e një prone të ligjshme kam marrë lejen e ndërtimit në komunë në bazë të studimit urbanistik të komunës Golem, në përputhje 100% me kërkesat e studimit", shton Frangaj. Po ashtu ai shprehet se do të ndërtojë dy fusha të reja sportive, në shërbim të komunitetit. Në reagim ndaj Frangajt, një nga banorët e kompleksit, Sotiraq Guga thekson se është ndër ata që xhelozhen "pse ju keni blerë dhe po ndërtoni në pronën tuaj konform ligjit (kjo sipas definicionit tuaj për të vërtetën dhe ligjin), por vërtet jam pjesë e atyrë që kur mësuan të vërtetën (tuaj) refuzojnë ta pëlqejnë ate".

Madje duke komentuar nuk Frangajn, Guga e cilëson lejen manipulim. "Nuk ka nevojë të njohësh shumë nga ligji për të kuptuar manipulimin flagrant që ju keni bërë (qoftë edhe duke përdorur ligjin) për të ndërruar pronësinë e terreneve sportive, e më keq për të ndryshuar destinationin e tyre në mënyrë arbitrare", shprehet Guga. Gjithashtu ai shton se komuniteti i Laguna Blu ndiheti mashtuarnga Agim Shëndjella dhe EPIDAM "i cili na ka siguruar në momentin e shitjes së aparatmenteve tona se ambientet e përbashkëta janë të patjetërsueshme (dhe kjo është e shkruar në kontratat tona); e dyta, ndjehemi të dhunuar nga ju, që pa konsensusin tonë si komunitet ju shqyeni dyert e kompleksit". Duke komëntuar dhe njerëzit me pushtet që janë banorë të Kompleksit Guga thekson se banorët janë të zhgënjyer për apatinë dhe paburrërinë e "sa e sa njerëzve me pushtet apo exponent të mediave në komunitetin e Laguna Blu, të cilët këto dite ju kanë sharë juve nëpër dhëmbë e nën zë, me libër shtëpie, por nuk guxojnë të bëjnë asnjë hap publik për të mbrojtur pronën e tyre (në këtë rast). Imagjino shpresen që ne, njerëzit e parëndësishem, kemi besuar tek ata".

ALUIZNI: 11 mln dollarë për kompensimin e pronarëve

Artan Lame në Kuvend: Në total 450 mijë aplikime, 90 mijë prej tyre rrezikojnë

LORENC RABETA
TIRANE

Nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje ALUIZNI ka arkëtuar rreth 16 milionë dollarë, 11 milionë prej të cilave janë vënë në dispozicion të kompensimit të pronarëve të prekur nga ndërtimet pa leje. Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame raportoi dje se deri tani janë shpërblyer 499 subjekte, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje, ndërkohë që u është kaluar e drejta e pronësisë mbi truallin rreth 5 mijë ndërtuesve pa leje. "Nga vlera (rreth 1.9 miliard lekë) e mbledhur nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore për periudhën 2014-2015, janë transferuar në fondin special të kompensimit, afro 1.3 miliardë lekë të cilat përdoren për shpërblimin e pronarëve, pronat e të cilëve janë zënë nga ndërtimet pa leje", tha Lame gjatë raportimit të djeshëm në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese.


Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame

RREZIKOHEN 90 MIJË OBJEKTE

Ndërsa theksoi se në total numërohen rreth 450 mijë aplikime për legalizime, Lame sqaroi se numri real i tyre është 350 mijë, për shkak të përsëritjes së tyre. "Ka shumë mbivendosje vetëdeklarimesh. Numri real i aplikimeve nuk është 450 mijë, rreth 100 mijë janë mbivendosje dhe dublime, pra kemi rreth 350 mijë reale", sqaroi Lame. Ndërkohë që sipas kreut të ALUIZNI-t, 90 mijë prej këtyre legalizimesh kanë problematika të rënda, gjë që e bën shumë të vështirë përfshirjen e tyre në proces. "Po të heqim rreth 60 mijë të bëra deri tani, mbeten rreth 290 mijë. Te këto 290 mijë, po të heqim rreth 90 mijë objekte të cilat në çfarë do lloj qeverie nuk mund të legalizohen, ose janë prishur, mbeten rreth 200 mijë objekte ende të legalziueshme. Ato 90 mijë që nuk legalizohen, të mos tremben njerëzit e të dalin në rrugë se po vjen ruspa. Qytetarët të rrinë në shtëpitë e tyre se gazetarët aq duan për ta kthyer në lajmë këtë. I vë shumë rëndësi kësaj që të mos krijojmë tension te qytetarët", tha Lame.

BRENDA MANDATIT

Sipas kreut të ALUIZNI-t, 200 mijë të mbeturat janë realisht objektet për t'u legalizuar. Këto 200 mijë objekte mund t'i ndajmë në dy blloqe: blloku i ndërtimeve që gjenden në zonat informale, të cilat po ecin me shpejtësi maksimale. Dhe zonat brenda qyteteve që, sipas Lames, janë një kalvar i vërtetë. "Për dhjetë legalizime që bëhen në zonat informalet, bëhet një në qytet. Për shkak të gjyqeve, mbivendosjeve, problemeve të pronësisë. Pra brenda qyteteve ecet shumë ngadalë. Por ama, në momentin që do mbyllim masën e madhe të zonave rrethuese të qyteteve, bie stresi i legalizimeve. Legalizimet do të bëhen standard, pasi përfundohen gjyqi, pasi familjarët merren vesh me njëri-tjetrin, në këtë mënyrë legalizimet do të vazhdojnë me qetësi edhe për shumë vjet. Në këtë mandat qeveritar do të mbyllim me urgjencë legalizimet në zonat informale. Më pas do vazhdojmë me legalizimet në qytete, të cilat kanë problematikë shumë më të theksuar, pasi të mos harrojmë që gjyqet vazhdojnë me vite të tëra, pesë apo shtatë vite. Masa e madhe e ndërtimeve që krijojnë stres dhe kanë nevojë për legalizim mbyllet në këtë mandat qeverisës", tha Lame.

OBJEKTET

Sipas Lames, është kryer evidentimi faktik në terren për 124.332 ndërtime pa leje. Kjo procedure, përfshin përditësimin në terren të gjendjes ndërtimore dhe plotësimin e hartimin e dokumentacionit teknikoligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj.). Për peridhën 2006-2015, janë dhënë 57.000 leje. Është përfubduar legalizimi i 15.294 ndërtimeve në vitin 2014 dhe 19.714 të tjerave për periudhën janar-26 tetor 2015.

LEGALIZMET, 450 MIJË VETËDEKLARIME

- Nga procesi i legalizimit ALUIZNI ka arkëtuar rreth 16 milionë dollarë
- 11 milionë në dispozicion të kompensimit të pronarëve të prekur nga ndërtimet pa leje
- Numri i aplikimeve është 450 mijë, por rreth 100 mijë janë përsëritje dhe dublime
- 90 mijë objekte me probleme të rënda, vështirë të legalizohen
- 200 mijë objekte mund t'i ndajmë në dy blloqe: blloku i ndërtimeve që gjenden në zonat informale, të cilat po ecin me shpejtësi maksimale
- Është kryer evidentimi faktik në terren për 124.332 ndërtime pa leje
- Për periudhën 2006-2015, janë dhënë 57.000 leje.
- Është përfunduar legalizimi i 15.294 ndërtimeve në vitin 2014 dhe 19.714 të tjerave për periudhën janar-26 tetor 2015.

5 MIJË

Kreu i ALUIZNI-t Artan lame raportoi dje se deri tani janë shpërblyer 499 subjekte, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje

1.3 MILIARDË

Janë transferuar në fondin special të kompensimit, afro 1.3 miliardë lekë të cilat përdoren për shpërblimin e pronarëve, pronat e të cilëve janë zënë nga ndërtimet pa leje

REAGIMI/ LAME HEDH POSHTË AKZUAT PËR DREJTORESHËN E DURRËSIT

ALUIZNI: Asnjë punonjës nuk ka lidhje me tenderat

Lidhur me akuzat e opozitës për tenderimin e shërbimit të matjeve në terren në favor të bashkëshortit të një prej drejtueseve të ALUIZNI-t Durrës, Lame tha se nuk ka asgjë të vërtetë. "Me përgjegjësinë maksimale të institucionit, ju them se nuk ka asnjë lidhje gjinore midis punonjësve të institucionit, të çdo niveli, nga drejtori e poshtë, në drejtoritë rajonale me tenderat e hartuar", tha Lame. Për tenderimin e shërbimit të matjeve në terren të objekteve, Lame u shpreh se nuk bëhet fjalë për shërbim konsulence, siç akuzon opozita, por për një shërbim në terren i cili nuk mudn të mbulohet nga burimet njerëzore të ALUIZNI-it. Sipas Lames, vetëm gjatë kohëve të fundit nga institucioni janë larguar rreth 30 specialistë në drejtim të projektit TAP, i cili ka nisur punën në terren në Shqipëri. Diçka e tillë ka bërë që ALUIZNI të punësojë të rinj e pa eksperiencë në terren. "Kjo është edhe arsyeja për të cilën i jemi drejtuar subjekteve private për të kryer matjet në terren për llogari të ALUIZNI-t", tha Lame.



8 MIJË LEKË

Duke ju referuar pagesave në drejtim të kompanive që do të kryejnë në terren matjet për llogari të ALUIZNI-t, lame tha se këto kosto janë të përcaktuara më së qarti me ligj dhe nuk shkojnë përtej kuotës 8 mijë lekë për njësi. "Çdo përmasë e pagesës është e rregulluar me ligj të veçantë. Nuk e shpikëm në çmimin. Është një vendim qeverie që thotë jo më shumë se 8 mijë lekë për njësi. Thelbi i tenderave drejt kompanive private ishte thirrja për të gjetur cila e tyre na e kryente atë shërbim për më pak se 8 mijë lekë për njësi? U paraqitën rreth 20 kompani, pasi jemi në një sektor shumë të specializuar, ku nuk mund të ofrojë kushdo. Madje një pjesë e tyre u bashkuan për të mundur të hyjnë në garë, për të plotësuar njëra tjetër, pasi aq janë kushtet e Shqipërisë", tha Lame.

KOSTOT

Duke ju referuar pagesave në drejtim të kompanive që do të kryejnë në terren matjet për llogari të ALUIZNI-t, Lame tha se këto kosto janë të përcaktuara më së qarti me ligj: deri 8 mijë lekë për njësi

Paratë e pista, Shqipëria jo më nën monitorim

Publikohet Raporti i Komitetit Moneyval të KE: Pleniumi heq Shqipërinë nga lista e vendeve nën vëzhgim

LORENC RABETA
TIRANE

Shqipëria nuk figuron më në listën Këshillit të Evropës e vendeve nën monitorim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Mbledhja e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, ka publikuar raportin përfundimtar ku konfirmon se autoritetet shqiptare kanë përmbushur detyrimet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Që prej vizitës në nëntor 2010, Shqipëria ka bërë progrese dhe ka implementuar masat e kërkuara për përforcimin e efektshmërisë së masave kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit, dhe njëherësh ka ngritur kuadrin ligjor e rregullator në në nivelin e rekomandimeve të Task Forcës për Aksionin Financiar, thekson në raportin përfundimtar Mbledhja e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës. "Për pasojë, Pleniumi vendosi ta heqë Shqipërinë nga lista e vendeve nën monitorim", thekson raporti.

PROGRESI

Shqipëria ka bërë progres të gjithanshëm në lidhje me mangësitë e konstatuara nga Moneyval, në aspektin legjislativ, bashkërendim ndërinstitucional dhe forcim të kapaciteteve teknike, masa të cilat kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit të sistemit parandalues dhe goditës në këtë fushë. "Shqipëria ka amenduar Kodin penal për t'u dhënë zgjidhje deficencave teknike të identifikuara nga raporti i vlerësimit. Kategoritë e shkeljeve janë mbuluar dhe elementët fizikë të pastrimit të parave janë ngritur në nivelin e kërkuar prej Konventave të Vienës dhe Palermos. Vërehet një trend në rritje i dënimeve për pastrim parash, dhe rastet e paraqitura përfshijnë dënime për një gamë të gjerë krimesh në fushën e pastrimit të parave, përfshi edhe rastet e kryera nga palët e treta. Për më tepër, ndryshimet e reja ligjore tregojnë zhvillime pozitive për sa i përket fleksibilitetit në grumbullimin e provave të nevojshme për të siguruar dënimet për pastrim parash", thekson raporti.

REKOMANDIMET

Progresi i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke koordinuar punën me të gjitha institucionet shqiptare të përfshira në këtë proces dhe masat e marra për trajtimin e mangësive janë shqyrtuar në sekretariatin e Moneyval, i cili ka çmuar progresin e bërë dhe në vendimmarrjen e tij komiteti, në seancën e 48-të plenare, që u mbajt në Strasburg në datat 14 – 18 Shtator 2015, ka vendosur heqjen e monitorimit të këtij institucioni për Shqipërinë. "Autoritetet shqiptare kanë hedhur hapa domethënës në përmbushjen e problemeve të identifikuara në Rekomandimin 5. Pas amendimeve në ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Terrorizmit, një kuadër i përshtashëm ligjor është ngritur edhe lidhur me masat mbi informacionin që u kërkohet individëve, i cili është në masë të madhe në nivelin e rekomandimeve. Masat e marra nga autoritetet shqiptare e kanë ngritur nivelin e përmbushjes në Mjaft Kënaqshëm", thekson raporti.

PROGRESI

Shqipëria ka bërë progres të gjithanshëm në lidhje me mangësitë e konstatuara nga Moneyval, në aspektin legjislativ, bashkërendim ndërinstitucional dhe forcim të kapaciteteve teknike

KONVENTAT

Kategoritë e shkeljeve janë mbuluar dhe elementët fizikë të pastrimit të parave janë ngritur në nivelin e kërkuar prej Konventave të Vienës dhe Palermos

PROVAT

Për më tepër, ndryshimet e reja ligjore tregojnë zhvillime pozitive për sa i përket fleksibilitetit në grumbullimin e provave të nevojshme për të siguruar dënimet për pastrim parash



DEKLARATA

Veliaj: Po rikuperojmë punën e 4 viteve



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka deklaruar se institucioni që ai drejton po rikuperon punën e katër viteve të bashkisë së Tiranës në një kohë rekord. Kryebashkiaku i kryeqytetit në një postim në faqen e tij në Facebook shkruan: "Po mundohemi të rikuperojmë 4 vite rrënim në kohë rekord. Na ndihmoni t'i ruajmë nga abuzimet, është qyteti ynë ky! Faleminderit për durimin. #TiranaNePune". Veliaj nëpërmjet postimit të tij sjell imazhe nga puna për ndriçimin e qytetit të Tiranës, që duket se vijon dhe në orët e mbrëmjes.

PËRPLASJA

Çarje PS-LSI në Mirditë, sekretar i këshillit zgjidhet një i djathtë



Në Bashkinë e Mirditës u zhvilluan dje zgjedhjet për Sekretarin e Këshillit Bashkiak. Në këtë post është zgjedhur me 12 vota pro, Gasper Topollaj, anëtar i kryesisë së Partisë Demokratike. Këshilli i Bashkisë së Mirditës përbëhet gjithsej nga 21 anëtarë, 16 prej të cilëve nga koalicioni majtë PS-LSI dhe 5 nga koalicioni i djathtë. Megjithatë, kjo nuk e ka penguar anëtarin e djathtë që të zgjidhet me 12 vota pro dhe 7 kundra, ndërkohë që 2 nga anëtarët mungonin në zgjedhje. Ky votim tregon edhe njëherë një 'rrjedhje votash' nga koalicioni i majtë që shkojnë në favor të PD-së.

SIGURIMET/ PRESIDENTI AVNI PONARI SQARON PROBLEMATIKAT

SIGAL UNIQA takim informues me gazetarët dhe përfaqësuesë të medias

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri zhvilloi një takim informues me përfaqësuesë të medias për të folur mbi zhvillimin dhe sfidat e tregut të sigurimeve në vend si dhe nevojën e një media të informuar. Ky është i pari takim i këtij lloji nga një kompani sigurimesh. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA zhvilloi dje një takim me përfaqësuesë të medias në vend dhe figura publike aktive në media, për të folur për tregun e sigurimeve në Shqipëri, sfidat dhe potencialet e zhvillimit të këtij tregu. Është hera e parë që në Shqipëri zhvillohet një takim i tillë. Drejtori i Përgjithshëm i Sigal Uniqa Group AUSTRIA, Avni Ponari, vuri theksin tek nevoja e një mediaje të informuar për tregun e sigurimeve, gjithashtu domosdoshmërinë që media duhet të luajë për informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për t'u siguruar. Duke bërë një analizë të tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, Ponari tha: "Shqipëria renditet e fundit në rajon për sigurimet, me vetëm 16 Euro për frymë, ndërkohë që nëse krahasohemi me vendet e tjera shifrat arrijnë në qindra Euro për vendet fqinje, ndërsa në vendet e BE-së qytetarët paguajnë një mesatare prej 2154 eurosh për frymë. Nisur nga shifrat e mësipërme, rrjedhimisht edhe pesha që ka industria e sigurimeve në GDP është tepër e vogël. Në Shqipëri të ardhurat nga sigurimet zënë vetëm 0.6% të GDP-së, kur Italia ka një volum primesh të sigurimeve 8.1% të GDP-së". Në takim u fol edhe mbi faktin se si mund të ndryshohet trendi i sigurimeve, pasi aktualisht në Shqipëri kemi një treg sigurimesh ku 60% e të cilit përbëhet nga shitja e sigurimeve të detyrueshme të makinave, duke lënë në plan të dytë rëndësinë e sigurimit të jetës, shëndetit, pasurisë, biznesit etj.



Meta në SHBA: Do të ndihmojmë në krizën e refugjatëve

Kryetari i Kuvendit, zhvilloi disa takime me zyrtarë të nivelit të lartë në SHBA

Esiona Konomi
TIRANE

Shqipëria do të japë kontributin e saj në përballimin e krizës së refugjatëve. Këtë garanci e ka dhënë kryetari i Kuvendit, Ilir Meta gjatë takimeve që ka zhvilluar me kongresmenë amerikanë. Meta u takua me Kryetarin e Komisionit të Ligjeve dhe Procedurave në Kongres, Pette Sessions, me të cilin u diskutuan çështje të bashkëpunimit mes dy institucioneve, rritja e shkëmbimeve parlamentare dhe ofrimi i ekspertizës së Kongresit Amerikan përmes Librarisë së Kongresit për çështje të hartimit të ligjeve dhe zbatimit të kushtetutshmërisë, marrja e eksperiencës për shërbimet e Kuvendit dhe rritja e transparencës së veprimtarisë parlamentare. Në këtë takimi u diskutua edhe mbi reformat e rëndësishme që po ndërmerren në vend, veçanërisht ajo në fushën e drejtësisë. Gjithashtu, u shkëmbyen edhe mendime mbi çështje të rëndësishme të sigurisë si situata në Lindjen e Mesme dhe Mesdhe, kriza e refugjatëve, situata në rajon dhe u theksua roli i Shqipërisë si një faktor paqeje dhe stabiliteti, si dhe angazhimi i Shqipërisë për të dhënë kontributin e saj në përballimin e krizës së refugjatëve. Kryetari i Kuvendit, u prit në takim edhe nga Kryetari i Komisionit të Jashtëm në Kongres, Ed Royce, me të cilin u bisedua për çështje të politikes së jashtme dhe të sigurisë, roli i Shqipërisë në NATO dhe kontributi në misionet paqeruajtëse, roli i Shqipërisë në rajon si një faktor i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin, roli i shqiptarëve në rajon për rritjen e komunikimit mes vendeve dhe perspektiva e integrimit. Në takim u diskutua dhe për çështje të tjera, si lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe masat që po ndërmerr Shqipëria në këtë drejtim. Më tej, gjatë vizitës Meta u prit nga Kryetari i Nënkomisionit për Evropën në Kongres, Dana Rohrabacher, me të cilin u diskutua për çështje të bashkëpunimit ekonomik dhe rëndësisë së rritjes dhe nxitjes së interesit të biznesit amerikan për të investuar në Shqipëri në sektorë strategjikë dhe ekonomi. Gjate takimit u diskutua edhe për rrezikun me të cilin përballet rajoni nga ndërhyrjet e jashtme dhe nevoja për më shumë konektivitet dhe projekte të përbashkëta rajonale dhe sesi SHBA mund të kontribuojnë në këtë drejtim. U theksua se Shqipëria është një partner i rëndësishëm i SHBA në rajon dhe se do të vazhdojë të mbetet e tillë.


Ilir Meta zhvilloi disa takime me zyrtarë të nivelit të lartë në SHBA


Ilir Meta gjatë takimeve që ka zhvilluar me kongresmenë amerikanë

ENGEL

Meta u prit në një takim edhe nga kongresmeni Eliot Engel, të cilin e vlerësoi si një mik të madh të Shqipërisë. Gjatë këtij takimi, u vlerësua roli i Shqipërisë si faktor paqeje dhe stabiliteti.

CHERTOFF

Meta u takua me ish-sekretarin e "Homeland Security", Michael Chertoff me të cilin diskutuan për rritjen e bashkëpunimit mes agjencive të inteligjencës për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.

EKSPOZITA/ KRYEMINISTRI ÇON PIKTURAT E TIJ NË AZI

Rama: Investoni në Shqipëri, treg rajonal me 26 mln banorë

Kryeministri Edi Rama u prit dje në rezidencën e qeverisë nga Guvernatori i Hong Kongut, Leung Chun-Ying. Kryeministri Rama, theksoi nevojën e rritjes se shkëmbimeve tregtare, dhe shtoi se të investosh në Shqipëri, do të thotë të investosh në një treg rajonal prej 26 milionë banorësh. Kryeministri Rama ftoi investitorët e Hong Kongut për të qenë më prezent në Shqipëri. Guvernatori Leung Chun-Ying, e u angazhua për të nxitur investitorët vendas e të huaj për projekte në Shqipëri në fushën e turizmit dhe tregtisë. "Sot me Guvernatorin e Hong Kongut, Leung Chun-Ying, për interesin e përbashkët dhe nismat konkrete për rritjen e bashkëpunimit ekonomik e të shkëmbimeve tregtare mes Hong Kongut dhe Shqipërisë në një fazë të re historike për rajonin tonë, ku, të investosh në Shqipëri, do të thotë të investosh në një treg rajonal prej 26 milionë banorësh",-shkruan Rama në Facebook, në fund të takimit. Kryeministri Edi Rama gjatë një pronoincimi ku foli për qëllimin dhe rezultatet e kësaj vizite në Hong Kong, tha se Shqipëria paraqet një treg më të gjerë se territori i saj. "Ne kemi dy vjet që po përpiqemi në mënyrë sistematike që të mbjellim farën e një ndryshimi të rëndësishëm në aspekt të investimeve të huaja direkte. Shenjat e para tanimë janë të qarta. Por ndërkohë puna vazhdon dhe ne shumë shpresojmë që edhe nga kjo pjesë e botës të ketë një interesim për Shqipërinë, po jo thjesht për Shqipërinë, por me mesazhin se kush investon në Shqipëri investon në një treg shumë më të madh sesa Shqipëria, duke pasur parasysh zhvillimin e rëndësishëm politik dhe të bashkëpunimit në rajonin tonë." Shqipëria, theksoi Kryeministri Rama, ofron fusha shumë interesante për investimet, të cilat përbëjnë edhe sektorët prioritarë të mbështetjes ekonomike.


Edi Rama me Guvernatorin e Hong Kong-ut Leung Chun-Ying

EKSPOZITA

Pikturat e Kryeministrit janë shfaqur edhe në Azi. "Në përfundim të vizitës 36 orëshe në Hong Kong u çel në Akademinë Jao Tsung ekspozita e titulluar Calendar Blossoms, për të cilën interesimi i mediave ishte i pazakonshëm"- shkruan Rama.

TAKIMET NË FIER

Basha: Falim kamatëvonesat, ulim edhe çmimin e energjisë



Në vijim të turit "Fjalën e kanë qytetarët", kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha u takua dje me banorë dhe tregtarë të Fierit. Gjatë takimit, Basha ka rikthyer dhe një herë premtimet e dhëna në fushatën zgjedhore të pushtetit vendor. "Sot duam të konfirmojmë këtu para biznesit të vogël fierak, për ju dhe për shqiptarët anembanë, vendimin tonë dhe vendosmërinë time për të falur pa kusht të gjithë kamatëvonesat e energjisë elektrike shqiptare. Ne do të ulim çmimin e energjisë, duke e ulur me 15% TVSH-në për biznesin dhe me 19% TVSH-në për të gjithë konsumatorët. Ulja e çmimit të energjisë do të sjellë po kështu rritje të konkurrueshmërinë në tregun e brendshëm dhe natyrisht eksporteve", deklaroi Basha.
Ndërsa ka dëgjuar një nga një shqetësimet e tregtarëve, shefi i opozitës solli në vëmendje rënien e ekonomisë shqiptare në raportin vjetor të Bankës Botërore, atë për "Doing Bussines". Sipas tij, nuk është vetëm opozita, por edhe institucionet ndërkombëtare i kanë hequr një kryq të madh qeverisjes së Edi Ramës. "Ndërkohë që Edi Rama është në luks të shfrenuar në hotelet më të shtrenjta të Hong-Kongut për të ftuar gjoja biznesmenët që të vijnë në Shqipëri, Banka Botërore thotë që Shqipëria ka rënë në pikatë për sa i përket klimës së biznesit, ka rënë në pikiatë korrupsionit, ka rënë në pikiatë për shkak të politikës arbitrare me energjinë, me biznesin, me taksat. Pra, tashmë nuk është vetëm opozita, nuk janë vetëm qytetarët por janë edhe institucionet ndërkombëtare që i kanë hequr një kryq të madh të qeverisjes së Edi Ramës, të cilët duke iu bashkëngjitur analizës tonë për faktet" – u shpreh Basha.


Cyan magenta yellow black

Mos lëshimi i kuponit, 3 vjet burg nëse përsëritet shkelja

"Nga gjobë 5 mln lekë, në burg nga 5 ditë deri në 3 vjet"

LEONARD QUKU
TIRANE

Mos lëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, nga personi i cili ka detyrimin t'i lëshojë në momentin e transaksionit, do të përbëjë shkelje administrative me gjobë deri në 500 mijë lekë të vjetra dhe në rast përsëritje do të ketë ndëshkim penal, nga 5 ditë burg deri në 3 vjet. Këto janë ndryshimet që komisioni parlamentar i ligjeve miratoi dje në Kodin Penal, pas propozimit të qeverisë për të kthyer disa masa administrative në vepra penale të cilat dënohen me burg. Pas shqetësimit të ngritur nga deputetët socialist dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim një ditë më parë, se neni 13 i Kodit Penal i ndryshuar, ishte i paqartë në pikën se kush do të mbante përgjegjësi, administratori apo punonjësi, qeveria solli një tjetër formulim që parashikon penalizim të personit që ka detyrimin e lëshimit të kuponit tatimor. "Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të paregjistruar në organet tatimore, moslëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, nga personi i cili ka detyrimin ta lëshojë në momentin e transaksionit, kur më parë është dhënë masa administrative, përben vepër penale dhe dënohet deri në 3 vjet burgim", thuhet në nenin 13 të ndryshuar në Kodin Penal. Ndonëse opozita kërkoi që mosdhënia e kuponit të mbetet kundërvajtje, qeveria theksoi se nuk ka ndërmend të përkrahë informalitetin. "Moslëshimi i kuponit tatimor nuk mund të përbëjë krim, sepse nuk përben krim në asnjë vend të Bashkimit Evropian edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", u shpreh deputeti demokrat Eduard Halimi. Por, për ministren e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ermonela Felaj, opozita ka vendosur të mbrojë informalitetin. Ajo theksoi se qeveria nuk tërhiqet nga aksioni i saj për formalizimin e ekonomisë. "Qeveria po i thotë jo informalitetit dhe nëse opozita ka vendosur që të mbrojë informalitetin le ta bëjë sot këtë dhe gjithë ditën. Ne nuk kemi ndërmend të tërhiqemi nga kjo histori sepse informalizëm është bërë ekonomia dhe çdo gjë tjetër në këtë vend, kemi arritur në këtë pikë, pikërisht për këtë shqiptarët janë të varfër", tha Felaj. Ndërsa nënkryetari demokrat i komisionit parlamentar të ligjeve, Oerd Bylykbashi deklaroi se masat e qeverisë janë represive dhe synojnë të frikësojnë biznesin. Sipas tij, gjobat dhe dënimet shkelin proporcionalitetin, pasi edhe një që shet byrekë do të dënohet me 500 mijë lekë gjobë dhe me 3 vjet burg për një byrek të lëshuar pa kupon që kushton 300 lekë të vjetra. "Pyetja është shumë e thjeshtë, burg do të bëjë edhe një shet byrekë të cilët kushtojnë vetëm 300 lekë të vjetra? Është fshehje të ardhurash edhe ai që nuk dorëzon kuponin tatimor për një byrek zonja ministre? Mbasi ka marrë një gjobë 5 milionë lekë të vjetra për kuponin e parë që nuk lëshoi, burg do të bëjë për të dytin ai? 3 qind lekë të vjetra kushton", u shpreh deputeti demokrat Oerd Bylykbashi. Importimi, eksportimi apo tranzitimi i paligjshëm i mallrave të ndaluar ose të kufizuara që hyjnë e dalin në Republikën e Shqipërisë, i kryer me çdo mënyrë a mjet qoftë, dënohen me burgim deri në dhjetë vjet. Kontrabanda për mallrat e akcizës dënohet me 7 deri 10 vite burg. Tregtimi i mallrave kontrabandë dënohet nga 3 deri në 10 vjet burg.


Neni 13
Pas nenit 180 shtohet neni 180/a, me këtë përmbajtje:
Neni 180/a
Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të paregjistruar në organet tatimore, moslëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, nga personi i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin tatimor në momentin e transaksionit, kur më parë është dhënë masë administrative, përben vepër penale dhe dënohet deri në tre vjet burgim."

Faksimile e nenit 13 të Kodit Penal

DËNIMI

Se mbi kë do të rëndojë dënimi për veprën penale me burg, ligji parashikon se detyrimi bie mbi personin i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin. Megjithatë, Prokuroria dhe Gjykata do të përcaktojnë fajësinë e punëdhënësit apo punëmarrësit


Komisioni Parlamentar i Ligjeve

INTERVISTA/ NUK SHQETËSOHEM PËR NOFKËN "KAUBOJ" S'KAM KRITIKUAR RAMËN, POR PS-NË E LEZHËS

Sot betimi, Eduart Ndocaj në Kuvend me makinën e "Al Pacino"-s

Surprizat e Eduart Ndocajt s'kanë fund. Deputeti i njohur me nofkën "kaubojsi" do të shkojë sot në Kuvend për të bërë betimin para kolegëve të tij me makinën e përdorur në filmin "IL Padrino". Nuk është një model i ngjashëm "Alfa Romeo", por bëhet fjalë për të njëjtën makinë e cila është përdorur nga aktori legjendar Al Pacino. Të paktën këtë ka deklaruar dje në një bisedë me redaksinë e Shqiptarja.com ligjvënësi më i ri që pritet të ulet në karrigen e deputetit. Ai tha se mendon të vijë ndryshe në seancën plenare të së enjtes, ndërsa gjatë një interviste për "Report TV" u shpreh se do të jetë në Kuvend një zë i fortë në mbrojtje të qytetarëve. Gjithashtu, Ndocaj ka një përgjigje edhe për ata të cilët e quajnë "kauboj".


Eduart Ndocaj

Z.Ndocaj, do të jeni deputeti më i ri i Kuvendit. I zgjedhur nga listat e PS në zgjedhjet e 23 qershorit të 2 viteve më parë, a do ta mbështesni këtë parti në Kuvend dhe a do ta mbështesni qeverinë Rama?

Duke qenë se unë isha kandidat i PS në zgjedhjet e 23 qershorit të 2013-ës, patjetër që do të mbështesim mazhorancën dhe këtë qeveri, pasi mendojnë se ka hapësira për përmirësim në këto dy vite që do të vijnë.

Keni patur një përplasje me kryeministrin Edi Rama. Për një drekë të paguar nga ju, për një prishje marrëdhëniesh. A vazhdoni tu qëndroni atyre fjalëve që keni thënë më parë?

Unë s'dua ta quaj përplasje apo ofendime. Ishte një kujtesë që në atë kohë, PS-ja e Lezhës bëri disa deklarata jo komode për figurën time si kandidat i listës së deputetëve. Dhe ishte një përgjigje që unë jam kontribuues i kësaj mazhorance dhe duke i treguar se kam drekuar edhe me kryeministrin dhe stafin e tij disa herë.

Pra, nuk ishte një akuzë e drejtpërdrejtë për kryeministrin Edi Rama?

Ishte një përgjigje për Partinë Socialiste të Lezhës, për disa akuza të pavenda që bëri në atë kohë kryetari i degës së asaj kohe, i cili s'është më aktualisht.

Pak ditë më parë deputeti Ndoka deklaroi se do të jeni pjesë e PDK. Do të jeni pjesë e kësaj partie, e konfirmoni këtë gjë?

Unë do të jem deputet i mazhorancës. Duke qenë se jam edhe nënkryetar i PDK dhe PDK është në koalicion me PS, unë jam deputet i mazhorancës. Jam deputet i qarkut të Lezhës, i qytetarëve të Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit. Dhe jam deputet i emigracionit që në këto 25 vite është hera e parë që emigrant arrin të hyjë në parlament dhe shpresoj që kjo është një ogur i mirë për të ardhmen, pasi emigrantët kanë 25 vjet të lënë në harresë dhe ne duam të kemi hapësirat tona dhe kuotat tona si pjesë e emigracionit pasi jemi 60% e popullsisë dhe duam të votojmë atje. Dhe kjo do të jetë një nga pikat e mia në parlament.

PËR RAMËN

Unë s'dua ta quaj përplasje apo ofendime. Ishte një kujtesë që në atë kohë, PS-ja e Lezhës bëri disa deklarata jo komode për figurën time si kandidat i listës së deputetëve. Dhe ishte një përgjigje që unë jam kontribuues i kësaj mazhorance dhe duke i treguar se kam drekuar edhe me kryeministrin dhe stafin e tij disa herë

A do t'i kërkoni qeverisë votën e emigrantëve në zgjedhjet e ardhshme parlamentare?

Para një jave pash disa shoqata që nuk i njoh dhe midis tyre ishte edhe kryetari i PS për Italinë, i cili kërkonte votën e emigrantëve. Mendoj se kryetari i Parlamentit, i cili doli në mbështetje të kësaj ideje, e ka në dorë ta fusë në agjendë dhe ta realizojë pasi në këto 25 vite ne nuk arrijmë të shprehim votën tonë, të zgjedhim apo të zgjidhemi në Parlamentin e Shqipërisë. Nuk dua të ketë pengesa në këtë drejtim, sepse ndryshe nuk mund të kemi demokraci të sigurt, nëse emigracioni përjashtohet siç është përjashtuar në këto 25 vjet.

Si deputet i Lezhës, Kurbinit dhe Mirditës, si do t'i shërbeni qytetarëve?

Qarku i Lezhës është një nga zonat më të varfra të Shqipërisë, me një hapësirë të jashtëzakonshme ku është investuar shumë pak. Duhet të zbresim në terren për të dhënë kontributin tonë. Të shohim se çfarë nevojash kanë qytetarët. Kontributi duhet të jetë në terren dhe jo në foltoren e parlamentit.

Jeni etiketuar se do të jeni një deputet "kauboj". Është e vërtetë apo do t'i përkushtoheni politikës tërësisht?

Njeriu mund të dalë në fotografi me kapele dhe fakti se vendos kapele nuk do të thotë se është "kauboj". Do të jem në shërbim të qytetarëve dhe jo "kaubojve". Nuk më intereson si më kanë vënë nofkën, por unë jam një qytetar i thjeshtë i cili erdhi nga emigracioni dhe dëshiroj të kontribuoj për këtë vend, me aq mundësi sa do të kem.

Cyan magenta yellow black

Kufiri detar, 'Pakti i ri, ose arbitrazh ndërkombëtar'

Ministri Bushati: Me Greqinë po hartojmë një dokument të ri për të adresuar probleme të mbartura"

Esiona Konomi
TIRANE

Zgjidhja e konfliktit për kufirin detar me fqinjin tonë jugor, Greqinë, ka dy rrugë sipas shefit tonë të diplomacisë, Ditmir Bushati: ose një marrëveshje e re, ose alternativa e fundit është arbitrazhi ndërkombëtar. "Ose do të ketë një rinegociim të një marrëveshje të re në objektin e saj, sepse në gjykimin tonë por duke ju referuar dhe Gjykatës Kushtetuese, gabimi i palës shqiptare fillon që nga objekti i marrëveshjes që ka qenë në negocim me Greqinë. Dhe rruga tjetër është arbitrazhi ndërkombëtar",-ka thënë ministri Bushati gjatë një leksioni me temë "A ka Shqipëria një politikë të jashtme", mbajtur në auditorin e Fakultetit të Shkencave Sociale në Tiranë. Ministri ka folur edhe për çështjet e tjera lidhur me Greqinë, duke nënvizuar avancimet me një diplomacie "me hapa të vegjël", siç e quan ai. "Kur mora detyrën, marrëdhëniet me fqinjin tonë jugor ishin thuajse të ngrira, të mbizotëruara nga një frymë mosbesimi dhe nga mungesa e kontakteve të nivelit të lartë. Aktualisht, falë asaj që unë e quaj "politika e hapave të vegjël", kemi vënë në veprim një aksion diplomatik të përqendruar te arritja e rezultateve konkrete dhe jo te retorikat e ënjtura me pathos nacionalist."-shprehet ministri. Bushati përmend zgjidhjen e çështjes së toponimeve si një sfidë e tejkaluar. "Zgjidhja e çështjes së "Toponimeve" ishte veç fillimi i përpjekjes sonë për të tejkaluar sfida të mbartura nga e kaluara. Gjatë dy viteve të shkuara rifilloi puna e komisioneve dypalëshe, ndërsa Greqia pranoi se Ligji i Luftës krijon një situatë anormale dhe të papranueshme midis fqinjësh"-tha Ditmir Bushati. Shefi i diplomacisë shqiptare, theksoi se nuk ka më tema tabu mes dy vendeve, por as me rajonin. "Qëndrimet tona konsistente kanë treguar se me


Ditmir Bushati

Greqinë mund të diskutojmë si palë të barabarta për çështje të cilat duhen trajtuar ballazi, pa drojë dhe pa komplekse. Nuk ka më tema tabu, por vetëm sfida që duhen tejkaluar. Tanimë, kemi hyrë në një fazë të re gjatë së cilës po hartojmë një dokument të ri për të adresuar probleme të mbartura dhe për të çliruar potencialin pozitiv të marrëdhënies sonë",-shprehet ministri Ditmir Bushati. Sipas tij, qasja pa tabu dhe pa droje, vihet re edhe në ecurinë e marrëdhënieve tona me Serbinë. "Simbolika e vizitave të ndërsjella, është pasuar nga disa hapa normalizues në kuadër të Procesit të Berlinit, ku mund të veçoj nismën për bashkëpunimin rinor sipas modelit franko-gjerman. Unë jam dhe mbetem realist për sa i përket vështirësive që ka marrëdhënia me Serbinë"-tha Bushati. Ai sqaroi auditorin se disa prej boshteve kryesore që orientojnë politikën tonë të jashtme janë: integrimi evropian, partneriteti transatlantik, fqinjësia e mirë shoqëruar me një projektim më efikas të Shqipërisë në rajonin Adriatiko-Jonian dhe ndërvepruesmëri më e madhe në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.

KUBA

Bushati: Nuk votuam kundër SHBA-ve në OKB

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati sqaroi dje votën e Shqipërisë, pro heqjes së embargos ndaj Kubës në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Në votimin e dy ditëve më parë, Shqipëria votoi njësoj me me të gjitha vendet anëtare të BE-së, por ndryshe nga SHBA-të, një nga partnerët e vendit tonë. "Shqipëria nuk ka votuar kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës ditën e martë. Shqipëria ka votuar në mënyrë konsistente me atë linjë që e ka të përvijuar prej kohësh. E njëjta rezolutë është hedhur thuajse çdo vit dhe Shqipëria, pavarësisht çfarë qeverish kanë ardhur apo kanë ikur, ka votuar njësoj", deklaroi ministri Bushati. Mbështetjen ndaj Kosovës Bushati e vlerësoi si një proces i vijueshëm dhe i pandërprerë me të gjithë influencën që Shqipëria ka. "Nënshkrimi i MSA me BE-në shenjon ankorimin e Kosovës në rrjedhat evropiane. Kosova e meriton anëtarësimin në UNESCO dhe ne do të vijojmë ta mbështesim në sintoni të plotë me partnerët tanë strategjike"

LAJME SHKURT



Berisha do të jem deputet dhe pas vitit 2027

Ish-Kryeministri Sali Berisha nuk do të heqë dorë nga politika, të paktën deri në zgjedhjet e vitit 2027. Në një intervistë televizive Berisha I pyetur nëse do të vijojë të jetë në parlament pas kësaj legjislature është shprehur se do të jetë "Edhe pas zgjedhjeve të vitit 2027". Ndërsa ka shtuar se përzgjedhja e emrave që do të jenë në listën e kandidatëve nuk do të varet vetëm nga kryetari I PD-së Lulzim Basha por dhe nga angazhimi që ka secili prej deputetëve aktual. Kështu I pyetur nëse lista do të jetë në dorën e Bashës, Berisha përgjigjet se kjo varet "edhe nga puna, deputetët që punojnë shumë e meritojnë!"

Kushtetuesja: Mandati i Kokëdhimës më 23 nëntor, PD padit Kuvendin



Gjykata Kushtetuese do të shqyrtojë me 23 nëntor kërkesën ankimore të PD-së, për të konstatuar si të papajtueshëm ushtrimin e mandatit nga deputeti Koço Kokëdhima. "Gjykata vendosi që ta pranojë kërkesën për të marrë pjesë si subjekt i interesuar deputeti Koço Kokëdhima në seancë dhe të shtyjë seancën gjyqësore me datë 23 Nëntor, ditë e Hënë ora 10:00", tha dje kryetari Bashkim Dedja. Avokati i deputetit kërkoi që të ishte palë në këtë proces, kërkesë kjo që u kundërshtua nga PD. Avokati Ivi Kaso tha se çështja është shqyrtuar në themel nga Kuvendi dhe vendimi i këtij institucioni është në kundërshtim me kushtetutën.

Peleshi: Raportin e BB e prisnim, shkak bllokimi ndërtimeve



Zv.kryeministri, Niko Peleshi duke komentuar raportin e "Doing Bizness", u shpreh në të njëjtën linjë arsyetimi si ministri i Zhvillimit Ekonomik, Arben Ahmetaj. Peleshi tha se qeveria shqiptare e priste humbjen e disa pozicioneve për shkak të reformave të ndërmarra në urbanistikë. Sipas tij, pika e dobët ishin "lejet e ndërtimit" të cilat janë bllokuar si dhe vendimi i qeverisë për të prishur ndërtesat pa leje. Zv.kryeministri, duke folur në takimin ndërkombëtar të biznesit, deklaroi se qeveria ka miratuar një paketë ligjesh që do t'i japë një impuls të ri ekonomisë.

Teknologjia më e fundit me
Cyberknife dhe TrueBeam / Metoda më e
Avancuar për Trajtimin e Kancerit



Konsulta Falas Nga Mjeku Onkolog

Datë: 13.11.2015 vjen ne Tirane
Assoc.Prof.Dr.Banu Atalar
Profesor i Rrezatimit dhe Onkologjisë



ACIBADEM
HOSPITALS GROUP

Ju mirëpresim në Zyren tone të Përfaqesise Acibadem në Tiranë
Adresa: Rr "Muhamet Gjollesha", prane shkolles "Sabaudin Gabrani".
Per te caktuar nje orar ju lutem telefononi ne: 069 22 66 525

Cyan magenta yellow black

DREJT PUNËS
Suplement i SHQIPTARJA.com
E ENJTE 29 tetor 2015 Nr. 47 www.shqiptarja.com



Punonjëse Burimeve Njerëzore Era 2000 shpk

Kandidatja duhet të plotësojë këto kushte:
• Të ketë diplomë universitare, (fakulteti juridik).
• Të ketë notë mesatare mbi 8-të.
• Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 2 vjet.
• Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze, e shkruar dhe e folur.
• Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe pune në grup.
• Të njohë mirë programet bazë kompjuterike.
• Preferohet mosha 25-35 vjeç
Shënime
Ju mund të dërgoni cv në adresën e emailit: eshqypi@era.al

Koromani: Nga Tirana në Rotterdam, ja pse u largova

Nuk janë të paktë studentët shqiptarë që mund të gjejnë hapësira studimore dhe shkencore jashtë vendit! Një ndër to është edhe Fjorda Koromani, e cila përmes këtij rrëfimi na tregon arsyet e largimit nga Shqipëria në Rotterdam, pritshmëritë e saj në Netherlands Institute for Health Sciences, ku parësore është studimet për frakturat vertebrale, si dhe ditët e bukura që kalon në vendin e bukur të Rotterdamit. Edhe pse është vetëm 27 vjeçe, Fjorda thotë se pavarësisht mallit që ka për familjen, miqtë, kthimi nuk është në axhendën e planeve të afërta. Ajo e

Doktorantja e cila studion në Hollandë, na rrëfen projektet

bindur, ka një mesazh për të gjithë të rinjtë, ku thotë se mos harroni në asnjë moment të pyesni "Pse?" dhe t'i përgjigjeni, si dhe vendoseni



Më mungon familja, shoqëria, e folura më këmbë e me duar...

gjithmonë në dyshim autoritetin.

Fjorda, ti je duke kryer doktoraturën në Rotterdam në Qendrën Mjekësore Erasmus MC. Mund të më tregosh pak më tepër mbi punën që po kryen?

Unë jam duke studiuar faktorët gjenetikë që ndikojnë në osteoporozë, në Laboratorin Gjenetik të Departamentit të Mjekësisë Interne në Erasmus MC si dhe në Departamentin e Epidemiologjisë. Specifikisht studioj frakturat e vertebrave si një shenjë shoqëruese e osteporozës, në lidhje me faktorë të ndryshëm risku. Pasi i identifikoj këta faktorë risku dhe vërtetoj që janë të lidhur me fraktuarat e vertebrave...

lexoni në faqe 15

INTERVISTA/ NJE RREFIM NGA TAULANT MUKA NE AMERIKE

MJEKU QE PREKU ENDRREN NË HARVARD

Një rrëfim mbi sfidat, internshipet në USA e Cambridge

NGA **Izaura Ndoj**
TIRANE

Historia e djalit që studio për vite me radhë dhe ishte një ndër aktivistët më të zellshëm të Fakultetit të Mjekësisë, është befasuese, por në të njëjtën kohë edhe një rrugëtim plotë sfida. Bëhet fjalë për Taulant Mukën, djalin nga Skrapari i cili në këtë rrëfim na tregon të gjithë rrugën e tij plot sakrifica për të prekur ëndrrën e tij, Harvardin! Në këtë intervistë për "Shqiptarja.Com", ai ndalet hap pas hapi në rrugëtimin e tij, i cili nisi me diplomimin në vitin 2012 si mjek në Universitetin e Tiranës, për të vazhduar me specializimin 6 mujor në Universitetin e Bolonjës dhe më pas mori një diplomë MSc në Shëndetin Publik. Por, nuk...

lexoni në faqe 14



Mario Peqini

Në garë për "Pastiçerin më të mirë"

Mario Peqini është shqiptari 28-vjeçar që ëmbëlson Italinë. Por ndonëse është një nga pastiçierët më të mirë, ai është dhe një nga konkurrentët në emisionin "Il più grande Pastiçiere" që transmetohet në Rai2. Në puntatën e parë, djali nga Durrësi, ka arritur të kalojë në raundin tjetër, e ndërsa në fund mes 30 konkurrentëve do të dali pastiçeri më i mirë i Italisë. Mario Peqini prej kohësh e konsiderojnë si artistin e pastiçerisë me një kurrikulum të pasur që do t'ia kishte zili edhe...

lexoni në faqe 16

Cyan magenta yellow black

IZAURA NDOJ
TIRANE

Taulant Muka: Mjeku që ndoqi ëndrrën, Harvardi suksesi i parë

Një rrëfim mbi sfidat profesionale, internshipet në USA dhe Cambridge



Historia e djalit që studio për vite me radhë dhe ishte një ndër aktivistët më të zellshëm të Fakultetit të Mjekësisë, është befasuese, por në të njëjtën kohë edhe një rrugëtim plotë sfida. Bëhet fjalë për Taulant Mukën, djalin nga Skrapari i cili në këtë rrëfim na tregon të gjithë rrugën e tij plot sakrifica për të prekur ëndrrën e tij, Harvardin! Në këtë intervistë për "Shqiptarja.Com", ai ndalet hap pas hapi në rrugëtimin e tij, i cili nisi me diplomimin në vitin 2012 si mjek në Universitetin e Tiranës, për të vazhduar me specializimin 6 mujor në Universitetin e Bolonjës dhe më pas mori një diplomë MSc në Shëndetin Publik. Por, nuk mjaftoi kjo, Taulanti po punon si hulumtues shkencorë në ErasmusAGE, një qendër për plakjen në të gjithë rrjedhën e jetës dhe prej pak kohësh ka prekur Amerikën, Harvardin ëndrrën e shumë të rinjve. Edhe pse duket optimist në rrëfimin e tij për Shqipërinë, ai thotë se edhe pse i mungon vendlindja, do të vazhdojë të ndjek ëndrrën e tij për t'u perfeksionuar akoma më tej.

Një djalë shqiptarë që sot studion në Harvard. Na tregon rrugën e sfidave që ke ndjekur për të arritur në këtë pikë?

Harvardi është një mjedis inspirues. Është një institucion që të krijon mundësi të reja duke të lejuar të kapërcesh eksperiencat tona të zakonshme dhe limitimet. Udhëtimi drejt Harvardit ka filluar me studimet për mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës. Në 2006, kur u regjistrova si student në degën e mjekësisë, nuk e kisha menduar veten se do gjendesha në Harvard pas disa vitesh. Pasi përfundova studimet ne Tiranë, përmes programit ERAWEB të Komisionit Europian (në të cilin ishte pjesë edhe Universiteti i Tiranës në atë kohë) arrita të fitoja një bursë studimi Master në Shëndet Publik në Erasmus Medical Center, Hollandë (Erasmus MC). Pas përfundimit të masterit,departamenti në të cilin bëra internship-in, më ofroi mundësinë të vazhdoja me studimet doktoraturë. Ne Erasmus MC pata mundësinë të njihesha me shkencën, në kualitetet më të larta të saj, pas së cilës u apasionova dhe tek e cila e shoh të ardhmen time sot. Besoj ishte puna, përkushtimi dhe fati gjithashtu që më dhanë mundësinë të kaloj sot një pjesë të studimeve të mija të doktoraturës në Harvard. Jam shumë i lumtur për këtë arritje e cila nuk do ishte e mundur pa besimin dhe ndihmën e supervizorit tim të doktoraturës Prof. Oscar H. Franco, të cilin dua ta falenderoj.

Prej pak kohësh ndodhesh në USA për një internship. Ku konsiston ky kërkim shkencor?

Aktualisht jam në Harvard School of Public Health për një internship 6 mujor. Sëmundjet kardiovaskulare janë shkaku kryesor i mortalitetit; deri në vitin 2020, projeksionet tregojnë sëmundjet kardiovaskulare të shkaktojnë 73% të mortalitetit global dhe 56% të morbiditetit total. Për më tepër, diabeti i tipit 2, i cili është i shoqëruar me një risk 2 deri ne 4 fish më të lartë për sëmundje kardiovaskulare, po behët një epidemi globale. Puna ime kërkimore deri më sot është e fokusuar në identifikimin e faktorëve të riskut për këto dy sëmundje. Identifikimi i këtyre faktorëve mund të ndihmojë në zbulimin e proceseve të reja metabolike që çojnë në zhvillimin e sëmundjes dhe në detektimin e hershëm të personave që janë në risk të lartë, të cilët mund të përfitojnë nga strategji parandalimi, përfshirë ndërhyrje dietike, farmakologjike apo nga ndryshim i stilit të jetesës dhe për pasojë në uljen e përhapjes së sëmundjeve kardiometabolike. Më konkretisht, gjatë këtyre gjashtë muajve do studioj efektin që një dietë antioksidante ka në riskun për zhvillimin e diabetit të tipit 2. Gjithashtu, një tjetër projekt kërkimor, është ekzaminimi i llojeve të ndryshëm të yndyrnave në lidhje me riskun mbi diabetin tip 2. Deri para pak kohësh, mendohej se të gjitha yndyrnat kanë efekt negativ mbi shëndetin, por sot ka mjaftueshëm evidenca që tregojnë se disa lloje yndyrnash, si për shembull acidet yndyrore omega-3 mund të ulin inflamacionin e për rrjedhojë përmirësojnë parametrat kardiometabolik.

Pas një studimi të gjatë në Shqipëri ju nuk u 'dorëzuat; por ndoqët ëndrrën tuaj përtej trojeve shqiptare...?

Për shumë arsye, të jetosh në një vend tjetër është një zgjedhje e mirë, dhe për më tepër kur arsyeja është mundësia për një edukim më të mirë. Gjithsesi, të jetosh në një vend jo-amtar nuk është gjithmonë e lehtë; mund të hasësh shumë probleme si gjuha, socializimi, kultura e punës apo edhe diskriminimi. Diferencat në disa raste mund të jenë të mëdha. Për shembull, kur fillova studimet në Hollandë vura re që në punë ecet me një plan paraprak, çdo gjë është e mirë organizuar dhe njerëzit janë shumë të orientuar drejt objektivave të caktuara. Në Shqipëri në punë ne jemi më të relaksuar, fleksibël, eficenca nuk vlerësohet dhe aq shumë, vendimet janë kryesisht të momentit dhe socializimi në punë është një nga prioritet tona. Kur lëviza në Hollandë apo në Boston më vonë, mu desh të njihja më shumë mbi kulturën e vendit si dhe të kujdesesha për veten. Ky ishte një rast i mirë të fitoja pavarësinë time. Sot, jam i lumtur që jam zhvendosur në Hollandë. Një vend i ri, një jetë e re dhe sfida të reja.

SHQIPERIA

Shqipëria është pjesë e rëndësishme e jetës sime. Çdo mëngjes, e filloj ditën duke lexuar gazetat online në Shqipëri. Kam shumë dëshirë të qëndroj i updatuar me aktualitetin në vend.



Ju theksuat se po punoni si hulumtues shkencor në ErasmusAGE, një qendër për plakjen. Mund të na thuash diçka rreth saj dhe punës tuaj në këtë qendër?

ErasmusAge është një qendër shkencore brenda Erasmus MC që ka për qëllim të identifikojë faktorë nutricionalë dhe të stilit të jetesës që janë të shoqëruar me shëndetin përgjatë jetës në mënyrë që të zhvillojmë strategji efektive për përmirësimin e shëndetit. Kërkimi shkencor atje është i fokusuar në tre faza të rëndësishme të jetës: fëmijëria, shtatzënia dhe plakja. Në ErasmusAge, unë kam punuar në shëndetin kardiovaskular, kancer dhe osteoporozën, duke parë dietën dhe determinantët klinik të shëndetit në këto fusha. Gjithashtu jam përfshirë në projektet e Shëndetit të gruas, duke ekzaminuar rolin e menopauzës dhe ndryshimeve që lidhen me të (hormonet seksuale dhe simptomat vazomotore) me riskun kardiometabolik. Në këtë aspekt, përmes punën në ErasmusAge, kemi treguar që prezenca e simptomave vazomotre, si afshet apo nivelet e larta të hormonit femër estraiol në femrat pas menopauzës mund të rrisin riskun për zhvillimin e sëmundjeve kardiometabolike.

Shumë të rinj bëjnë zgjedhjet e gabuara. Ju jeni pjesë e atyre të rinjve që edhe në Shqipëri nuk ka qëndruar besnik vetëm studimeve, por keni kërkuar më shumë nga vetja?

Është e vërtetë, jam shumë i ndjeshëm ndaj padrejtësive dhe reagoj nëse shoh një të tillë. Frika ndaj institucioneve dhe mentalitetit nuk është pjesë e jetës sime dhe uroj shumë që gjeneratat e reja të jene më pak konformiste. Gjatë studimeve në Shqipëri kam qenë shumë aktiv në problematikën studentore, duke reaguar ne forma të ndryshme ndaj sistemit arsimor në vendin tonë. Edhe pse shihen disa progrese, sërish hapat janë shumë të ngadalta dhe duhet një reformë e thellë për të qenë afër standardeve perëndimore.

Ju mungon Shqipëria?

Sigurisht që po. Shqipëria është pjesë e rëndësishme e jetës sime. Çdo mëngjes, e filloj ditën duke lexuar gazetat online në Shqipëri. Kam shumë dëshirë të qëndroj i updatuar me aktualitetin në vend. Në Shqipëri kam edhe familjen, ç'ka e bën lidhjen edhe më të fortë. Në Hollandë, fatmirësisht, kam shumë miq nga Shqipëria, dhe një pjesë të madhe të kohës së lirë e kaloj me ta. Shpesh herë, bisedat tona janë mbi Shqipërinë, pasi të gjithë e ndjejmë mungesën e saj në një mënyrë a tjetrën.

Mendoni se një ditë të rikthehen në atdhe për ndërtuar një tjetër histori suksesi?

E mendoj gjithmonë si një opsion rikthimin tim në Shqipëri. Gjithsesi, mendoj se nuk është ende momenti i duhur për ta marrë këtë vendim. Aktualisht, jam i përqendruar në rritjen profesionale timen. Për më tepër, pavarësisht se marrë vazhdimisht oferta nga universitete dhe kompani prestigjioze në Europë dhe USA, nga Shqipëria ende nuk kam patur një ofertë për punë, që të reflektoj seriozisht për një rikthim atje.

Kush janë projektet tuaja në vazhdimësi?

Pas internship-it në Harvard, do shkoj për një tjetër internship në Cambridge, Angli, për të marrë dhe eksperiencën më të mirë Europiane përtej asaj amerikane në fushën ku studioj dhe punoj. Më pas do vazhdoj studimet post-doktoraturë në Erasmus MC. Gjatë dy viteve të ardhshme, do kem mundësinë të punoj në fushën e re të Epigenetics, një fushë e cila premton shumë në luftën ndaj sëmundjeve, përshirë sëmundjet kardiovaskulare. Deri më sot kemi menduar që fati jonë përcaktohej nga mozaiku gjenetik me të cilin kemi lindur, por sot ka evidence që përmes mekanizmave epigjenetikë mund të ndryshojmë gjenet tona.

IZAURA NDOJ
TIRANE


Fjorda Koromani

FJORDA Koromani: Nga Tirana në Rotterdam, ja pse u largova

Rrëfimi

Doktorantja e cila studion në Hollandë, na rrëfen arsyen e largimit, pasionin e saj për profesionin dhe projektet

Nuk janë të paktë studentët shqiptarë që mund të gjejnë hapësira studimore dhe shkencore jashtë vendit! Një ndër to është edhe Fjorda Koromani, e cila përmes këtij rrëfimi na tregon arsyet e largimit nga Shqipëria në Rotterdam, pritshmëritë e saj në Netherlands Institute for Health Sciences, ku parësore është studimet për frakturat vertebrale, si dhe ditët e bukura që kalon në vendin e bukur të Rotterdamit. Edhe pse është vetëm 27 vjeçe, Fjorda thotë se pavarësisht mallit që ka për familjen, miqtë, kthimi nuk është në axhendën e planeve të afërta. Ajo e bindur, ka një mesazh për të gjithë të rinjtë, ku thotë se mos harroni në asnjë moment të pyesni "Pse?" dhe t'i përgjigjeni, si dhe vendoseni gjithmonë në dyshim autoritetin.

Fjorda, t'i je duke kryer doktoraturën në Rotterdam në Qendrën Mjekësore Erasmus MC. Mund të më tregosh pak më tepër mbi punën që po kryen?

Unë jam duke studiuar faktorët gjenetikë që ndikojnë në osteoporozë, në Laboratorin Gjenetik të Departamentit të Mjekësisë Interne në Erasmus MC si dhe në Departamentin e Epidemiologjisë. Specifikisht studioj frakturat e vertebrave si një shenjë shoqëruese e osteporozës, në lidhje me faktorë të ndryshëm risku. Pasi i identifikoj këta faktorë risku dhe vërtetoj që janë të lidhur me frakturat e vertebrave, identifikoj variacionet gjenetikë që janë përgjegjës për ta.

Përse vendose ta kryesh doktoraturën jashtë Shqipërisë?

Arsyeja kryesore ishte të studiuarit në një institucion ndryshe nga ai ku kisha studiuar deri atëherë. Për mua dijet që kisha pas diplomimit nuk i përmbushnin pritshmëritë e mia dhe përgjegjësia kryesore për këtë i bie strukturës dhe organizimit të institucionit ku unë i kreva studimet. Për fat të keq, ne nuk na u mësua dhe nuk u nxitëm e as frymëzuam nga askush se si të sintetizojmë, krijojmë hipoteza apo menaxhojmë situata të panjohura, por vetëm se si të riprodhojmë dije të mësuar përmendësh apo si të kalonim provimet. Arsye tjetër ishte sepse në fushën konkrete ku unë po punoj, në Shqipëri nuk ka as të dhëna, as laborator, as fuqi kompjuterike të mjaftueshme dhe as specialistë të cilët punojnë në të. Gjithashtu doja të merrja pak pushim nga shteti Shqiptar dhe nga situatat absurde të çdo ditë që më thithnin çdo lloj energjie pozitive që kisha. E gjeja veten çdo ditë duke u munduar të menaxhoj faktin që gjërat ndryshe ishin në teori (apo në libra) ndryshe në praktikë dhe që duhet të përshtatesha me diçka që për mua ishte e gabuar. Ngado që hidhja sytë shihja punë të papërfunduara, rrugë të papërfunduara, projekte ndërtesash të papërfunduara, rikonstruksione të nisur dhe të lënë përgjysmë dhe nuk është çudi që shumë prej nesh shqiptarëve e marrim një punë dhe e lëmë për gjysmë, s'kemi patur shembull tjetër. Kryesisht për këto arsye vendosa të largohem.

Si e ndjen veten në Rotterdam? A ka qenë i vështirë ambientimi?

Qyteti është shumë i këndshëm dhe interesant! Ngado që hedh sytë



sheh ndërtesa që janë të tilla dhe vepra arti njëkohësisht dhe vë re që secila prej tyre tregon një histori. Gjithashtu, ka shumë hapësira të gjelbra dhe shumë ndriçim, saqë pjesa e preferuar e ditës për mua është kur kthehem në këmbë në mbrëmje për në shtëpi. Megjithatë, qyteti nuk ka vetëm arkitekturën të veçantë, por edhe faktin që në të jetojnë mbi 170 nacionalitete të ndryshme. Ka kaq shumë diversitet kulturash saqë kam thyer më shumë mite dhe paragjykime në një vit sesa në gjithë jetën time (qesh). Ambientimi nuk ka qenë i vështirë dhe arsyeja kryesore është sepse këtu kisha dhe miq të mirë të Universitetit nga Shqipëria të cilët më kështilluan me detaje dhe praktikisht më kursyen shumë lodhje. (Faleminderit Tao, Jana, Kozi, Adela, Bruna, Kodi (qesh).

Ti kthehemi studimeve. Çfarë procedurash ndoqe për t'i kryer ato në Erasmus MC.?

Universiteti i Mjekësisë kryen shkëmbime studentore ndërkombëtare brenda programeve të caktuar, midis të tjerash dhe Erasmus-Western Balkans (ERAWEB) në të cilin unë aplikova. Praktikisht çdo student ose ish-student i diplomuar në Universitetin e Mjekësisë mund të aplikojë, me një listë dokumentash standarde. Në rastin tim, meqenëse aplikova për program doktorature, dorëzova dhe një plan projekt të studimit që do kryej. Plan projektin e shkrova në bashkëpunim me supervizorin me të cilin do punoja nëse pranohej aplikimi.

A janë përmbushur pritshmëritë e tua në lidhje me studimet, në institucionin ku po punon?

Unë jam ende në fillim të rrugës, por më kujtohet kur ndiqja kurset e programit të masterit, literalisht më ziente koka nga njohuritë e reja dhe njëmijë pyetjet që më kalonin në mendje, pyetje të cilave për fat të mirë, një pjesë ju jam përgjigjur dhe një pjesë jam ende duke u munduar t'ju gjej përgjigjet. Nuk kalon ditë që mos të mësoj diçka vërtetë të re në fushën e shkencës dhe nuk kalon një situatë e vetme pa marrë mësime jete nga supervizori im (qesh) i cili është një nga njerëzit më të mirë, me më shumë durim dhe pasion për shkencën që kam njohur. Po, pritshmëritë deri tani janë përmbushur.

Cila është rutina e ditës tënde?

Rutina e ditës time varet nga dita (qesh). Të Hënën e nis gjithmonë me takim me supervizorin dhe të Mërkurën me takim me Departamentin, takime në të cilat diskutohet ecuria gjatë javës, rezultatet e punës dhe merren sugjerime apo ndihmë nëse na nevojitet dhe gjithashtu informohemi me ecurinë e punës së kolegëve. Zakonisht, çdo ditë ka prezantime apo seminare nëpër departamente të tjerë, të cilat i ndjek për t'u njohur me të rejat apo punimet e kolegëve dhe për t'i bërë trurit fiskulturë (qesh). Supozohet që punën ta mbyll në 17:30 (qesh), por kjo nuk ndodh asnjëherë. Dy deri në tre ditë në javë, në mbrëmje shkoj në kursin e volejbollit dhe një herë në javë në kurs frengjishteje.

Frengjisht?

Frengjishtja tingëllon shumë më bukur se hollandishtja.

Të mungon Shqipëria?

Oooh (trishtohet). Më mungon familja, shoqëria, e folura më këmbë e me duar, me zë të lartë, përqafimet dhe puthjet nga katër herë (qesh). Më mungojnë ditët me diell dhe malet.

Mendon të rikthehesh një ditë në atdhe?

Po sigurisht që e mendoj, besoj se çdokush që nuk jeton në vendin ku ka lindur, i kalon në mendje të kthehet atje, por jo, nuk kam plane konkrete në lidhje me kthimin.


Çfarë këshille do t'i jepje studentëve të rinj?

Mos harroni në asnjë moment të pyesni "Pse?" dhe t'i përgjigjeni, si dhe vendoseni gjithmonë në dyshim autoritetin.

Oferta Punësimi

Elektromekanik Algrafika

Shtypshkronja Progress kërkon kandidatë të kualifikuar dhe me eksperiencë për pozicionin ELEKTROMEKANIK.
Kualifikimet / Kërkesat
Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhte:•
Të ketë përfunduar Arsimin e Mesëm Profesional për Elektromekanik (përbën avantazh arsimi i lartë)
Të ketë experiencë të ngjashme 5-10 vite (e preferueshme eksperienca në shtypshkronjë)
Të jetë person i komunikueshëm dhe i aftë të punonjë në grup
Të ketë njohuri në mirëmbajtjen, regjistrimin, kontrollin e makinerive në shtypshkronjë
I aftë të përballoj volum pune dhe të punojë nën presion
Mosha e preferuar mbi 35 vjeç
Shënime
Të interesuarit të dërgojnë CV në adresën: algrafika.info@gmail.com



Asistent zyre AFEP INDUSTRY shpk

Shoqëria Afep Industry shpk publikon vendin vakant të punës, Asistent zyre, në zyrat qëndrore të kompanisë Afep Industry shpk.
Detyrat
Të ketë eksperiencë pune në këtë fushë
Të ketë njohuri të mira të paketës Ms Office
Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Italiane, gjuhës Angleze, gjuhës Spanjolle dhe gjuhës Serbe
Të ketë aftësi të punojë në grup dhe i pavarur
Të jetë i motivuar dhe të paraqesë vlera të larta bashkëpunuese
Shënime
Aplikantet duhet të dërgojnë cv me fotografi në adresat e e-mail: tecnicoal@afep.it segreteria@afep.it

Mario Peqini

Në garë për titullin "Pastiçeri më i mirë"







NË FOTO: Pastiçieri Mario Peqini

Mario Peqini është shqiptari 28-vjeçar që ëmbëlson Italinë. Por ndonëse është një nga pastiçierët më të mirë, ai është dhe një nga konkurrentët në emisionin "Il più grande Pastiçiere" që transmetohet në Rai2. Në puntatën e parë, djali nga Durrësi, ka arritur të kalojë në raundin tjetër, e ndërsa në fund mes 30 konkurrentëve do të dali pastiçeri më i mirë i Italisë. Mario Peqini prej kohësh e konsiderojnë si artistin e pastiçerisë me një kurrikulum të pasur që do t'ia kishte zili edhe një profesionist i fushës së tij në prag pensioni. Prej disa vjetësh është shef i repartit të ëmbëlsirave në një prej restoranteve më të vlerësuara në Itali, "Il luogo di Aimo e Nadia" në Milano. Mario ka shkruan në Milano nga Durrësi me familjen kur ishte vetëm 13 vjeç. Ka ndjekur një shkollë hotelerie dhe u diplomua si kuzhinier teknolog. Më pas u njoh me Aimo Moronin ku nisi të punojë menjëherë pas studimeve. Disa vite më vonë ai nisi studimet në institutin e arteve kulinare Etoilè në Chioggia. Ka punuar edhe krah Roberto Rinaldinit, pastiçier i njohur në Itali, për të përfunduar si shefi i pastiçerisë së restorantit prestigjioz milanez "Il luogo di Aimo e Nadia".

Mario ka ardhur në Milano nga Durrësi me familjen kur ishte vetëm 13 vjeç. Ka ndjekur një shkollë hotelerie dhe u diplomua si kuzhinier teknolog. "Ky i imi është një pasion që kam qysh kur isha fëmijë, dëshira që të gatuaj për të tjerët më vjen nga brenda". Shkolla i ofroi shumë mundësi falë stazheve, dhe kështu "pati fatin", siç thotë vetë për Shqiptariitalise.com vite më parë, të njihej me Aimo Moronin ku nisi të punojë menjëherë pas studimeve. "Në restorantin e tij pashë e mësova shumë e shumë gjëra të zanatit që më pëlqyen menjëherë. Vendosa të shkoj e të punoj si pastiçier, duke u përpjekur të ndjek teorinë e Aimos mbi shijen dhe harmoninë e ingredientëve". Më pas Mario nisi studimet në institutin e arteve kulinare Etoilè në Chioggia ku, - siç thotë ai me thjeshtësinë që e karakterizon, - i dhanë mundësinë për të zbuluar "lojërat, nevojat, vështirësitë, ngazëllimet dhe dhimbjet. Duke më mësuar artin e jetës mbi të gjitha, që të jem i aftë të bëhem pastiçier duke qëndruar me këmbët në tokë". Më pas ka punuar edhe krah Roberto Rinaldinit, pastiçier i njohur i AMPI-t (Accademia Maestri Pasticceri Italiani) në Rimini, dhe u bë Chef Chocolatier. Pas katër vjetësh, në moshën 24 vjeçare, u kthye sërish në Milano, te Aimo e pritën krahëhapur dhe entuziastë për gjithë ç'kishte mësuar dhe e caktuan Chef Patissier, rol mbulon edhe sot në restorantin prestigjioz. Në 2013-tën vlerësohet si "Shefi pastiçier më i mirë i vitit" nga "Identità Golose", guida përvitshme e restoranteve më të mira të Italisë, Europës dhe Botës që vlerëson kuzhinën dhe pastiçerinë e nivelit më të lartë.

Për Marion, guida jepte këtë motivim: "Ka jetuar gjysmën e jetës në Shqipëri, nga ku u largua bashkë me familjen kur ishte vetëm 13 vjeç. Me babanë magazinier dhe nënën rrobaqepëse, me pengesën e parë italishten, ka studiuar rëndshëm për t'ia dalë mbanë. Në stafin e 'Il luogo di Aimo e Dania', krijon ëmbëlsirat në sintoni të plotë me pjatancat e kripura të ofruara nga restoranti".

Marrë nga "Shqiptari i Italisë"

DREJT SHKOLLIMIT PROFESIONAL



Si të bëhesh kujdestar fëmijësh për dy muaj

Kujdestari i Fëmijve është një profesion që po gjen dita ditës terren në vendin tonë. Ofërtat e punësimit për dado (kujdestar fëmijësh) janë gjithnjë në rritje. Por është mjaft e vështirë për prindërit që të gjejnë persona të specializuar në këtë drejtim. Ndaj shkollimi është mjaft i nevojshmë për këtë degë dhe kurset për tu bërë kujdestar fëmijësh janë zgjidhje e mirë. Qendra e kurseve profesionale, e ofron specializimin ën këtë drejtim dhe nëj kursant që ndjek mësimet përgjatë dy muajve në fund të këtij kursi profesional është i aftë të përkujdeset për fëmijët nga mosha 1-6 vjeç në mjedise shtëpiake por edhe në institucione të përkujdesjes së fëmijëve, si çerdhe, kopshte etj.

KUJDESTAR FEMIJESH
Kohëzgjatja: 150 orë mësimore ~ 2 Muaj

Në përfundim të kursit të trajnimit për këtë profesion kursantët do të jenë të afta të:

- Zhvillojnë të fëmijët aftësitë e tyre lëvizore dhe shoqërore.
- Mbështesin zhvillimin edukativ dhe psikosocial të fëmijëve. Kryejnë ushqyerjen e fëmijëve.
- Kujdesen për veshjen dhe zhveshjen e fëmijëve.
- Kujdesen për fjetjen e fëmijëve.
- Garantojnë higjenën e fëmijëve dhe higjenën e mjedisit ku ata jetojnë.
- Parandalojnë dëmtimet e fëmijëve dhe rreziqet e sëmundjeve të ndryshme.
- Japin ndihmën e parë në raste dëmtimesh dhe sëmundjesh të fëmijëve.
- Shkëmbejnë informacion për fëmijët me prindërit dhe të afërmit e tyre.
- Respektojnë të drejtat dhe individualitetin e fëmijëve.
- Respektojnë konfidencilitetin e familjeve për fëmijët e të cilave kujdesen.
- Punojnë në ekip dhe grup si dy nga metodat më të kërkuara në tregun e punës.
- Mbrojnë pozicionin e tyre në institucionin ku do të punojnë, komunitet dhe më gjerë në shoqëri.
- Propozojnë ndryshime në programet që ndjekin kur këto të fundit bien në kundërshtim me parimet e institucionit apo parimet e punës me klientin.

Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik

Adresa: Rruga asim Vokshi, Tiranë pranë "Harry Fultz"
E-mail:www.kordinatori@gmail.com, Cel: 069 60 31119

Oferta Punësimi

Operatore për hedhje të dhënash në pc Albdesign

Kompania Albanian Digital Printing Solutions & Services (A.D.P.S) kërkon të punësojë: Operatore për hedhje të dhënash në kompjuter
Detyrat
-Verifikon saktësinë e të dhënave para se ato të regjistrohen në databazë
-Regjistron të dhënat në përputhje me dokumentacionin
-Gjen dhe korrigjon gabimet ose i raporton ato në supervizori
-Kryen arkivimin e dokumentacionit përkates
Kualifikimet/Kërkesat
Aplikantja duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
- Të jetë e aftë te shkruajë shpejt dhe saktë ne kompjuter
- Të ketë njohuri shumë te mira te gjuhes greke
- Të ketë mbaruar shkollën e mesme
- Mosha 18-40 vjeç
Eksperienca në Data entry do të merret ne konsideratë
Kandidatët të dërgojnë CV-n në adresën email: gj.lubonja@adps.al CV-t e dërguara duhet të jenë ne dy gjuhë: shqip dhe greqisht.
Ose te kontaktojne në numrin 0696033092
Testimet do të kryhen në gjuhën greke

AlbaGulf-Kompani Punësimi

Për të gjitha ju vajza që jeni të interesuara të jeni pjesë e stafit të një hoteli me 5* Alba Gulf jua mundëson këtë.
Jemi duke kërkuar
Kamariere, Recepsioniste dhe Hostess
Përshkrimi i punës:
Kohëzgjatja e Kontratës: 2 Vjet
Pagesa: E kënaqshme
Kushtet:
Avioni Falas (në fillim dhe në fund të kontratës)
Akomodim falas
Transport Falas
Uniformë Falas
Ushqim Falas (gjatë vakteve të punës)
Qëndrim Falas
Sigurimi i Jetës & Mbulimi i të drejtave për kompensimin e punëtorëve
Kërkesat
Njohuri mesatare të gjuhës angleze
Aplikoni tani tek: apliko@albagulf.al

Masterat, ja kush paguan dyfishin e tarifës së studimit

Datat kur nisin regjistrimet, dokumentat që duhen dorëzuar dhe tarifa që paguhet

Driçim Çaka
TIRANE

Vendimi i qeverisë për tarifat e programeve të studimit, përcaktonte tarifën për çdo kredit. Tarifat vjetore të masterit varjojnë nga 60 mijë deri në 150 mijë lekë të reja. Por studentët të cilët nuk përfundojnë në kohë degën që kanë filluar, apo kanë ngelur në një nga provimet do të paguajën dyfishine tarifës. Vendimi i miratuar nga qeveria parashikon rritjen e tarifës për programet e studimit "Master Profesional" dhe "Master Shkencor" në disa raste. "Studentët, të cilet nuk e kanë përfunduar programin përkates të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohezgjatjen normale të tij, dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndënpërsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar në këtë vendim", -përcakton vendimi i Këshillit të Ministrave.

REGJISTRIMET

Regjistrimet për programet e studimit sipas Ministrisë së Arsimit pritet të fillojnë javën e ardhshme. Kandidatët do të kenë në dispozicjon 10 ditë kohë për t'u regjistruar në një nga programet e studimit të masterave. Në lidhje me kriteret e pranimit, MAS thotë se qeveria i ka lënë në dorë të universiteteve këto kritare.




NGELËSIT

"Studentët, të cilet nuk e kanë përfunduar ende programin përkates të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohezgjatjen normale të tij"



AFATI

Regjistrimet për programet e studimit sipas Ministrisë së Arsimit pritet të fillojnë javën e ardhshme. Kandidatët do të kenë në dispozicjon 10 ditë kohë për tu regjisteuar në një nga programet e studimit



Ndërkohë Universiteti i Tiranës të kontaktuar nga gazeta ka konfirmuar se kriteri kryesor do të jetë mesatarja. Të pyetur nëse do të merret parasysh mesatarja Universiteti i Tiranës sqaron se "fillimisht kuotat do të shpërndahen për studentët të cilët kanë mbaruar studimet "Bachelor" në një nga fakultetet e këtij universiteti". Të njëtin fakt konfirmojnë edhe Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti Mjekësor, të cilët theksojnë se fituesit do të zgjidhen nga një kosmion i posaçëm.

DOKUMENTAT

Çdo kandidat mund të regjistrohet në një osë më shumë programe studimi, por në çdo rast duhet të paguajë tarifën prej 2500 lekësh të reja. Dokumentat që duhet të dorëzohen janë, fotokopje e noterizuar e diplomës, fotokopje e noterizuar e listës së notave si dhe mandat pagesën që ka paguar tarifën e regjistrimit. Universitete publike thonë se një kandidat mund të shpallet fitues vetëm në një degë dhe për këtë duhet të bëjë regjistrimin përfundimtar pas shpalljes fitues. Për vitin akademik 2015-2016 do të jenë 18 mijë e 239 kuota për master shkencor e profesional. Një pjesë e kuotave do të ofrohen për shtresat në nevojë. Këtë vit janë shtuar 46 degë të reja, në të gjitha universitete publike.

KATEGORITE

Kush do paguajë gjysmën e tarifës së masterit në shtet



Disa nga shtresat në nevojë do të paguajën gjysmën e tarifës duke filluar me personat që nuk shikojnë ose dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre.. Gjitahshtu paguajnë gjysmën e tarifës jetimët, romët dhe ballkano-Egjyptianët. Përfiton ulje edhe studenti, ku njëri nga prindërit e të cilit është ndara nga jeta dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore.

LAJME SHKURT



Rruga e Dajtit, Veliaj: Investimi mbyllet brenda nëntorit

Brenda nëntorit, përfundon rikonstruksioni i rrugës së Dajtit. Lajmi u bë i ditur dje nga kryebashkiaku i Tiranës, Erjon Veliaj gjatë inspektimit të ndërhyrjeve që po zhvillohen në këtë rrugë. "Më vjen mirë që investimin në këtë rrugë po e përfundojmë përpara afatit", u shpreh Veliaj. "Projekti përfunduar do të përfshijë parmakët metalikë, vendqëdnrimet e autobusëve, bankinat dhe sinjalistikë. Këto janë rrugë që bëhen me taksat e qytetarëve të Tiranës, ndaj i ftojmë gjithë qytetarët që t'i ruajnë investimet, që rrugët të mos vandalizohen e të mos ndoten", shtoi krei i bashkisë së kryeqytetit.

Shfuqizphet votimin tek Urdhrit i Mjekëve, reagon UMSH

Urdhri Kombëtar i Mjekëve, në një mbledhje të jashtëzakonshme ka shqyrtuar vendimin e Gjykatës Administrative, që shpall të pavlefshëm zgjedhjet në këtë organizatë. Padia ndaj zgjedhjeve të zhvilluara më 17 prill është bërë nga Valbona Doçi, drejtoreshë e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut në Tiranë. Sipas Urdhrit të Mjekëve, ndërhyrja po bëhet nga Ministria e Shëndetësisë ndaj një institucioni të pavarur dhe jo buxhetor. Sipas deklaratës së UMSH-së, dr. Doçi kandidoi dhe nuk arriti të merrte votat e duhura, pavarësisht presionit të ushtruar.



Adoleshenti shqiptar mahnit Greqinë, krijon robot me printer 3D


Një adoleshent shqiptar, fëmija i një emigranti në Greqi, tashmë bën pjesë ndër 6 shkenctarët e vetëm që kanë munduar të krijojnë një robot tredimensional. 15 vjeari Dhimiter Haxhi ka krijuar një robot nga një printer tredimensional dhe ka fituar një çmim nga Ambasada Amerikane në Greqi. Ai njihet si Dimitris Hatzis dhe studion në Kavala.Krijimi i këtij studenti është pjesë e një projekti që përqëndrohet në zhvillimin e jetës nga këndëvështrimi i i një roboti human të një dimensioni 3D. Në një njoftim të Ambasadës amerikane në Athinë, thuhet se "Hatzis është më i riu në moshë", që "ka mundur të përfundojnë këtë mision".

Masivi i gështenjave në Tropojë, së shpejti "Zonë e Mbrojtur"

Zona e masivit të gështenjave në Tropojë pritet të shpallet "Zonë e Mbrojtur" nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Kjo për shkak se AKZB vlerëson si të rëndësishme vlerën ekologjike dhe atë ekonomike të masivit të gështenjave në Tropojë. "Do të bëjmë përpjekjet maksimale që ky frut, që konsiderohet i shenjtë për ne, të përpunohet edhe në Tropojë. Sepse, është në interes të madh edhe të rritjes së punësimit edhe të rritjes së vlerës së këtij fruti nëqoftëse do të përpunohet këtu në Tropojë", shprehen Specialistët e mjedisit në këtë zone. Masivi i gështenjës në Tropojë zë një sipërfaqe mbi 2.400 hektarë.

Ushqimi me qumësht gjiri, UNICEF: Shqipëria kryeson

Në Shqipëri, niveli i ushqyerjes së fëmijëve me qumësht gjiri është më i larti në rajon. "Të ushqyerit me gji në Shqipëri, është më i lartë se sa në vendet e tjera të Ballkanit. Bosnja-Hercegovina 18%; ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë me 16%; Mali i Zi me 19% dhe Serbia me 15%. Megjithatë, përmirësimi i praktikave të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve të vegjël mbetet një sfidë, duke pasur parasysh nivelin e tregueseve të kequshqyerjes në Shqipëri, me një kombinim të dy formave në fëmijëri, nënpeshë dhe mbipeshë", thuhet në njoftimin zyrtar të UNICEF.



Sazani, së shpejti në rrjetin e ishujve mesdhetarë

Në ishujt francezë të Porquerrol, po mbahet takimi i parë i inisiativës për krijimin e një rrjeti të ishujve në Mesdhe dhe më gjerë, për një zhvillim të qëndrueshëm energjie të rinovueshme dhe turizëm ekokulturor. Në këtë takim po merr pjesë edhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për të referuar mbi ishullin e Sazanit. "Inisiativa e ishujve të qëndrueshëm e kryesuar nga Konservatori Littoral francez, mirëpret anëtarësimin e Sazanit në këtë rrjet botëror të ishujve, duke bërë të mundur një bashkëpunim më të mirë ndërkombëtar", ka thënë për mediat kreu i AKB-së, Auron Tare.

Neranxi: Premtimet elektrorale të qeverisë janë një kontratë

Biznesmeni Nikollaq Nereanxi Kryetar i SHMTT

Mbrojtja e interesave të tregëtarëve, zgjidhja e problemeve të tyre, si dhe marrëdhënie e drejtë e tregtarit me shtetin, u trajtuan gjerësisht në konferencën e Shoqatës për Mbrojtjen e Tregëtarëve dhe të Tregut. Kryetari i kesaj shoqate u zgjodh Nikollaq Neranxi, dikur deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në këtë konference ai solli eksperiencën e tij, si biznesmen, i cili e ka nisur aktivitetin si tregtar i vogël, më pas i mesëm dhe tani tek biznesi i madh me Kompaninë Neranxi. "Unë vetë, e kam filluar aktivitetin si tregtar i vogël, më pas i mesëm e tani jam tek biznesi i madh me Kompaninë Neranxi. Vizioni im është që në shoqatë duhet të përfshijmë të gjithë ata që merren me aktivitet privat, të vegjël, të mesëm e të mëdhenj. Një qeveri që është treguar e padrejtë me biznesin, gjithashtu e ka rrugën e shkurtër, por edhe një tregtar, i vogël ose i madh, nëse nuk e respekton shtetin, nuk do shkojë larg. Çdo qeveri që vjen, bën një kontratë me ne, premtimet e saj elektorale janë kontrata e tyre, të cilat siç kemi parë rëndom, më së shumti nuk janë mbajtuar, por ka ndodhur edhe më keq, është vepruar edhe në mënyrë të kundërt me atë që është premtuar", - u shpreh Neranxi.

APELI

"Një qeveri që është treguar e padrejtë me biznesin, gjithashtu e ka rrugën e shkurtër, por edhe një tregtar, i vogël ose i madh, nëse nuk e respekton shtetin, nuk do shkojë larg"

BANKAT

"Nuk kemi pse durojmë më banka që na zhvasin pa fund me interesa marramendëse dhe që i çon në faliment biznese të tëra, të mëdha e të vogla, por shteti të vendosë rregulla të qarta që janë në mbrojtjen tonë"

INFORMLITETI

Ne nuk kemi pse heshtim kur shohim se konkurrohemi në dritë të diellit nga biznesi informal. Dhe ky informali, do fitojë më shumë se sa ne që i paguajmë të gjitha detyrimet në shtet



PADREJTËSIT

Biznesmeni tha se konsultimi mes biznesit dhe institucioneve fiskale, është një detyrim. "Në Parlament bëhen ligje për ne dhe ne duhet të jemi pjesë e vendimarrjes", vuri theksin ai. Neranxi renditi një sërë padrejtësisht që po i bëhen biznesit duke filluar që nga interesat e bankave deri tek aksioni kundër informalitetit. "Ne nuk kemi pse durojmë më banka që na zhvasin pa fund me interesa marramendëse dhe që i çon në faliment biznese të tëra, të mëdha e të vogla, por shteti duhet të vendosë rregulla të qarta që janë në mbrojtjen tonë. Boll na ropën bankat dhe shteti bën sehir!

Ne nuk kemi pse heshtim kur energjia na mungon dhe na prishet malli, ose vjen me voltazh të ndryshueshëm dhe na prishen makineritë. Dikush duhet të na dëmshpërblejë për këtë.

Ne nuk kemi pse heshtim kur ju përzënë nga vendi ku tregtoni dhe ju çojnë aq larg sa konsumatorit më shumë i kushton karburanti sesa domatet që do blejë. Dhe kjo bëhet sepse dikush i lidhur me pushtetin, ia ka vënë syrin, vendit të tregut për ta bërë pallat apo diçka tjetër.

Ne nuk kemi pse heshtim kur shohim se konkurrohemi në dritë të diellit nga biznesi informal. Dhe ky informali, do fitojë më shumë se sa ne që i paguajmë të gjitha detyrimet në shtet, sepse ai përderisa ka marrë guximin të dalë në treg si informal, nuk ka shanse që të paguajë ndonjë taksë.

Ne nuk kemi pse heshtim kur proçedurat burokratike bëhen pengesë në punën tonë. Kur infrastruktura që duhej të na lehtësonte jetën dhe punën, në fakt na e bën atë më të vështirë, ndërkohë që ne paguajmë taksa për gjithçka, edhe për shumë shërbime që nuk i marrim", - theksoi Nikollaq Neranxi.

Me tej biznesmeni permendi një sërë problemesh që shqetësojnë tregetarët, si problem i TVSH-se, çmimet e referencës në dogana, çmimi i energjisë, ujit dhe karburantit për bizneset e vogla dhe të mëdha. Shoqata për Mbrojtjen e Tregetarëve dhe të Tregu, është krijuar në vitin 1998 dhe numëron rreth 9 mijë anëtarë në të gjithë Shqipërinë.

TË PAPUNËT / "NGA 150 MIJË TË PAPUNË QË JANË SOT NË SHQIPËRI, VETËM 20% DUAN TË PUNOJNË"

Klosi: Nuk sponsorizojmë dembelizimin në Shqipëri

Punkërkuesit duhet të nxirren nga gjendja që janë aktualisht, ku nuk duan të punojnë. Ishte kjo deklarata e Ministrit të Mirëqenies Sociale Blendi Klosi në Takimin e 2-të Ndërkombëtar të Biznesit. Klosi bëri të ditur se dembelizimi nuk do të sponsorizohet, duke ju referuar situatës së të papunëve që marrin ndihmë ekonomike apo pagesë papunsie. "Tashmë kemi gati një ligj shumë të fortë, që ka të bëjë me reduktimin e dembelizmit në Shqipëri. Ne duhet të gjejmë një raport të drejtë për ata që duan të punojnë dhe të jetojnë me punë të denjë, me ata që duan të jetojnë duke marrë ndihmën ekonomike apo asistencën sociale. Nuk mund të vazhdojmë të sponsorizojmë në pafundësi dembelizmin në Shqipëri", - u shpreh Klosi. Kjo, sipas tij mund të arrihet më së shumti duke krijuar së pari kushte që punonjësit të kualifikohen për të qenë të gatshëm që t'u përgjigjen kërkesave dhe standardeve të tregut të punës. Për të ndryshuar situatën e të papunëve MMS ka përgatitur një draft për të nxitur punësimin në vend. Klosi ka theksuar se për të mbetet një sfidë që të ndryshojë raportin mes punonjësve aktivë (që janë regjistruar në zyrat e Punës si të papunë dhe që duan të punojnë) dhe atyre pasivë (që janë regjistruar si të papunë dhe që nuk duan të punojnë) në vendin tonë. Sipas tij, nga 150 mijë persona që janë regjistruar si të papunë, vetëm 20 për qind e tyre duan realisht të punojnë, ndërsa pjesa tjetër kërkon që të qëndrojnë në këto lista për të marrë ndihmën ekonomike apo favoret e tjera që rrjedhin nga ky status. "Ne duhet ta nxjerrim Shqipërinë nga harta e vendeve që ofron vetëm punë të lirë. Ne duhet ta fusim Shqipërinë në hartën e vendeve që formon dhe ofron punonjës të kualifikuar. Kjo është detyra jonë e madhe, të ndryshojmë kryekëput raportin e tregut tonë të punës. Dhe ne mendojmë se ka një zgjidhje dhe ky është arsimi profesional", - tha Klosi në fjalën e tij.

TË PAPUNËT

Nga 150 mijë persona që janë regjistruar si të papunë, vetëm 20 për qind e tyre duan realisht të punojnë, ndërsa pjesa tjetër kërkon që të qëndrojnë në këto lista për të marrë ndihmën ekonomike



Ministri i Mirëqenies Sociale, Blendi Klosi

NDRYSHIMET

Ne duhet ta nxjerrim Shqipërinë nga harta e vendeve që ofron vetëm punë të lirë. Ne duhet ta fusim Shqipërinë në hartën e vendeve që formon dhe ofron punonjës të kualifikuar

RRJET SHKOLLASH

Sipas Ministrisë së Mirëqenies Sociale paraleliisht me reformën ligjore në sistemin e punësimit në vend, po punohet që brenda këtij viti të krijohet një rrjet i shkollave profesionale të ekselencës, të cilat të kenë mundësi që të prodhojnë profesionistë që mund të akreditohen nga sistemi i shkollave profesionale të BE-së, por edhe të jenë konkurrentë të denjë të tregut europian të punës. "Ajo që ne po bëjmë është që edhe në shkollat tona të krijojmë një grup të fuqishëm si shkolla ekselence dhe ato të jenë të gatshme që të prodhojnë profesionistë për tregun europian të arsimit profesional. Ne do përpiqemi që një numër i caktuar shkollash, brenda vitit që po flasim të kemi mundësi që të jenë shkolla të gatshme për akreditim nga BE-ja, duke krijuar të parët nxënës të kualifikuar shqiptarë që të jenë konkurrentë për tregun europian të punës. Sfida ime personale është që të kemi mundësi që, sa më shpejt të jetë e mundur, këto shkolla të ekselencës të mos jenë vetëm për shtetasit shqiptarë, por për të gjithë shqiptaro-folësit në rajon", - tha Klosi. Gjatë atkimit të dytë Ndërkombëtar të Biznesit është kërkuar që të mbështete arsimi profesiona dhe zhvillimi i tij, sipas kërkesave të tregut të punës dhe standardeve europiane. Sipas Ministrisë së Mirëqenies Sociale kjo është një nga mënyrat më të mira për të luftuar papunësinë në vend dhe për të krijuar kushtet për të jetuar me një punë të denjë.

GJENERALI Joseph Dunford kryetar i shefave të Shtabit të Përgjithshëm, tha se do të ishte i gatshëm të konsideronte rekomandimin e bashkimit të trupave amerikane me ata të Irakut kundër ISIS


Trupa amerikane në Lindjen e Mesme

CARTER Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Ashton Carter tha se Shtetet e Bashkuara nuk duhet të hezitojnë të mbështesin forcat lokale me "sulme nga ajri, apo veprime të drejtpërdrejta nga toka".

Trupat e SHBA, gati ndërhyrja në terren në Siri


Irani konfirmon pjesëmarrjen e parë në një konferencë paqeje lidhur me konfliktin sirian

Trupat amerikane janë duke përshkallëzuar presionin ndaj militantëve të Shtetit Islamik në Siri dhe Irak, duke mbështetur forcat lokale me një fushatë ajrore më të zgjeruar, si dhe ndonjëherë edhe përfshirje të drejtpërdrejtë në terren, ka bërë të ditur sekretari amerikan i Mbrojtjes, Ashton Carter, teksa ka folur përpara ligjvënësve këtë të martë. Duke dëshmuar në krah të Sekretarit Carter përpara Komitetit të Shërbimeve të Armatosura në Senat, gjenerali i Marinsave Joseph Dunford, gjithashtu kryetar i shefave të Shtabit të Përgjithshëm, tha se do të ishte i gatshëm të konsideronte rekomandimin e bashkimit të trupave amerikane me ata të Irakut në luftën kundër Shtetit Islamik, nëse kjo gjë do të përmirësonte mundësitë e mposhtjes së xhihadistëve.

Carter tha se fushata kundër ISIS ka evoluuar, ndaj dhe ushtria amerikane duhet të synojë të përforcojë përpjekjet në terren. Ai tha se marinsat amerikanë kanë për qëllim të intensifikojnë presionin ndaj bastioneve të ISIS në Raqqa të Sirisë dhe Ramadi të Irakut. Carter pret që e gjithë fushata ajrore e koalicionit të vendeve të Perëndimit të përshkallëzohet, me më shumë avionë luftarakë dhe me një shpeshtësi më të lartë të operacioneve. Ai tha se Shtetet e Bashkuara nuk duhet të hezitojnë të mbështesin forcat lokale me "sulme nga ajri, apo veprime të drejtpërdrejta nga toka".

Dunford tha se hedhja e trupave amerikanë në terren me forcat irakene mund të sigurojë efektivitet logjistik dhe të rrisë vetëdijen e shërbimeve inteligjente.

Një sulm ajror kundër ISIS-it gjatë javës së kaluar, në të cilën forcat amerikane kështilluan forcat kurde, rezultoi me vdekjen e një ushtari amerikan dhe shpëtimin e rreth 70 pengjeve.


Ushtria Siriane në një aksion

"Nëse kjo pati një impakt operacional apo strategjik dhe nëse ne duhet të përforcojmë pasjen e suksesit, atëherë kjo do të ishte korniza bazë e punës brenda së cilës unë do të rekomandoja shtimin e forcave për t'u rivendosur me njësitë irakene", tha Dunford.

IRANI

Ministri i Jashtëm i Iranit, Mohammad Javad Zarif, njoftoi se do të marrë pjesë në bisedimet shumëpalëshe, që organizohen këtë javë në Vjenë të Austrisë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje mbi konfliktin e përgjakshëm sirian.

Kjo do të përbëjë të parën herë, që Republika Islamike, aleate e Presidentit Bashar al-Assad merr pjesë në një samit të tillë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në bisedime do të jenë të pranishëm edhe përfaqësues të Rusisë, Arabisë Saudite dhe Turqisë.

Uashingtoni kishte pohuar më herët se Irani kishte ftuar të merrte pjesë në takim, lëvizje kjo që nuk është pritur edhe aq mirë nga opozita siriane, e mbështetur prej Perëndimit.

Raundi kryesor i negociatave pritet të mbahet të premten, edhe pse diplomatët sqarojnë se disa takime të shkurtra parapërgatitore mund të zhvillohen që të enjten mbrëma.

Ndërkohë, ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, ka biseduar me homologun e tij iranian Mohammad Javad Zarif rreth krizës në Siri, raporton Ministria e Jashtme ruse.

Përmes një bisede telefonike, që kanë zhvilluara Lavrov dhe Zarif, kanë kërkuar ndërmarrjen e të gjitha masave në mënyrë urgjente, për përmirësimin e dialogut politik në Siri.

Ata kanë dhënë se të gjitha vendet e rajonit duhet të përfshihen në këtë dialog.

LAJME SHKURT



Volkswagen, bilanc negativ për të parën herë në 15 vite

Skandali i "software"-ve, që manipulonin emetimet, ka fundosur financat e Volkswagenit. Për të parën herë në 15 vite, gjiganti gjerman i prodhimit të automobilave ka shkuar në minus gjatë tremujorit të tretë, duke deklaruar një humbje prej 1.67 miliardë eurosh. Kostot ligjore, të asaj që mediat e huaja kanë nisur ta etiketojnë si "dieselgate" do të rëndojnë mbi kompaninë edhe për pjesën e mbetur të 2015-s. Megjithatë drejtuesit e Volkswageni vazhdojnë të ushqejnë bindjen se shitjet do të rriten, ndonëse fitimet në total, për të gjithë vitin, llogaritet të kenë rënie të ndjeshme.

Mishi i konservuar, OBSH: Të dëmton nëse e ekzagjeron me konsumin

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka sqaruar se mishi i kuq dhe ai i përpunuar përbëjnë vërtet rrezik për shëndetin, por vetëm nëse abuzohet me konsumin e tyre. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i OBSH-së, Oleg Chestnov tha se përdorimi sidomos i produkteve të tilla si salçiçet e proshutat duhet kufizuar, megjithatë nuk ka përse eliminohen krejtësisht nga dieta ushqimore. Mishi i kuq aq më pak, u shpreh Chestnov, duke shtuar se problemet nisin nga konsumi i tepruar. Organizata europiane e përpunimit të mishit, "Clitravi" ka deklaruar se ka prova të padiskutueshme shkencore mbi të mirat e konsumit të mishit.

OKB: Kriza mes Izraelit dhe palestinezëve, rrezik katastrofik

Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Zeid Ra'ad Al Hussein deklaroi këtë të mërkurë se kriza mes Izraelit dhe palestinezëve rezikon të kthehet në një katastrofë. "Dhuna mes palestinezëve dhe izraelitëve do të na çojë në një katastrofë nëse ajo nuk ndërpritet menjëherë", thëksoi Zeid, gjatë një takimi special të Këshillit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në Gjenevë. Ndërsa, Presidenti palestinez, Mahmud Abbas i kërkoi komunitetit ndërkombëtar të krijonte sa më shpejt një regjim të mbrojtjes ndërkombëtare për popullin palestinez.





Maqedoni, Aksion policor në "Lagjen e Trimave" në Kumanovë

Mediat maqedonase kanë raportuar se në orët e para të së mërkurës, është zhvilluar një aksion i madh policor në "Lagjen e Trimave" në Kumanovë. Fokus i këtij aksioni mësohet se ka qenë shtëpia e Riza Jonuzit, i cili dyshohet se ka patur njohuri për konfliktin e armatosur në 9 maj të këtij viti, ku humbën jetën 9 policë. Dëshmitarë dhe familjarë të Riza Jonusit, janë shprehur për gazetën "Lajm" se ishte ora 05.00 e mëngjesit kur policia bastisi shtëpinë e tij. Ndërkohë, Ministria e Brendshme ka njoftuar se "nuk bëhet fjalë për një aksion policor, por është një kontroll rutinë i rregullt".

Emigrantët, Europa ashpërson masat



Europa po ashpërson masat për të ndalur fluksin e madh të emigrantëve që vërshon çdo ditë në portat e kontinentit të vjetër. Austria njoftoi planet për të ndërtuar ato që i quan barriera teknike në kufirin me Slloveninë, për të kontrolluar mijëra emigrantë që po hyjnë në territorin e saj. Ky vendim merret vetëm pak ditë pasi Presidenti i Komisionit Europian, Zhan Klod Juncker i kërkoi shteteve anëtare të mos merrnin aksione të njëanëshme për të luftuar krizën. Ndërkohë, Gjermania ka përshpejtuar deportimet e personave të cilëve u është refuzuar azili, mes të cilëve ka edhe shumë shqiptarë.

Turqi, policia merr nën kontroll dy televizione opozitare

Policia turke morri këtë të mërkurë nën kontroll regjinë e televizioneve "Bugun TV" dhe "Kanalturk" në Stamboll, që kanë lidhje me imamin Fethullah Gulen. Forcat e rendit hynë në selitë e dy kanaleve, pronësi e grupit "Koza-Ipek" duke shpërndarë me gaz lotsjellës dhe ujëhedhëse punonjësit që përpiqeshin të mbronin selinë, sipas imazheve të transmetuara nga "Bugun TV". Drejtësia turke vendosi të hënën të merret nën kontroll grupi "Koza-Ipek", i akuzuar se financon, rekruton dhe bën propagandë në emër të Gulen, ndërmarrjet e të cilit janë cilësuar "organizata terroriste" nga autoritetet.

AKTI I PAVARESISE

FAKTE TE REJA PER DOKUMENTIN ORIGINAL, NJE GJURME NE VITIN 1957

Vasfi Baruti
TIRANE

Për herë të parë vjen imazhi/ fotografia e dokumentit të Pavarësisë, ashtu siç s'është parë ndonjëherë kurrë më pare, si në ditën kur Ai shkruhej atë 28 Nëntor 1912, me të veçantën se në trup ka "plagë" të shumta, porqë asesi s'ia ulin vlerën historike...

ZBULESA E RE E DOKUMENTIT TË PAVARËSIMIT KOMBËTAR, NË DY PRURJE TË REJA BURIMORE DHE KRITIKA HISTORIKE

(Imazhi i origjinalit të dokumentit të 28 Nëntorit 1912)

1.E pabesueshme, ama e vërtetë e pamëshirë!

E pabesueshme, por e vërtetë e pamëshirë! Në orën 5:15 të mbrëmjes së 28 nëntorit 1912, Ismail Qemali, kryetari i Kuvendit të Pavarësisë në Vlorë, pa mbaruar togfjalëshin e tij "... Shqipëria e lirë dhe e mosvarme" në sallonin e madh të shtëpisë së madhe të Vlorajve flakëroi Flamuri i Pavarësisë dhe po njëheras nga katër delegatë të korit kishtar shqiptar të Kolonisë shqiptare të Rumanisë, të shoqëruar dhe nga kuvendarët e Pavarësimit, ushtoi kënga patriotike "Betimi mbi Flamur", shkruar e muzikuar nga kuvendari Murat Toptani, edhe atë çast e atë çast do të thotë atë çast të madhnueshëm mori jetë trisimboli tri herë i shenjtë: Vendimi i shpalljes së pavarësimit të Shqipërisë, rilindi Flamuri kombëtar nga hiri i vet me atë simbolikën e lashtë sa Zeusi, amá lindi edhe Hymni Kombëtar, që i këndonte Flamurit- kësisoj e padëgjuar kund tjetër më parë e më pas.

Të tjera të vërteta pabesueshme, por të vërteta të pamëshirë! E ndërsa në popuj e kombe të botës së qytetëruar ose jo simbolet historike janë të shënjta e të Kremte të mëdha, Trisimboli ynë i shënjtë u la e mbeti në vuajtje, si ato të Ferrit dantesk. Flamuri, që Ismail Qemali vetë ideoi dhe e ngriti me duart e veta dhe që atë çast e "pagëzoi" me ca fjalë aq të mençura bashkë me të puthurën mallëngjyese të tij, Ai edhe sot përvuan persekutim të egër. Hymni kombëtar, është i vetmi simbol që ka fituar lirinë, si në origjinë të tij. Ama, e keqja s'paska të fundme: Vendimi i shpalljes së pavarësimit kombëtar, dokumenti më i rëndësishëm i Shqipërisë së re politike, vijon të vuajë tmerret e pafundme të kalvarit komunist, me gjithfarë gjymtime e operacione tmerri në trupin e tij të shenjtë, madje edhe sot në dokument mbeten të fshirë- censuruar gjashtë firmëtarë të pavarësimit (që më 1965) dhe mënxyra se ai, i censuruari, ka fituar të "drejtën" e qytetarisë thuajse në të gjithë botimet historike, madje e ato të 100 vjetorit të Pavarësisë, e ato të Akademisë së Shkencave të Republikës.


Akti i Pavarësimit të Shqipërisë, nga 25 vjetori i Pavarësisë kur publikohej për herë të parë i censuruar vendçe nga Oborri në "Ekspozita Rilindja Kombëtare" e kur dokumenti botohej me dinjitet shkencor në dy formate, të njëditshme, nga firmëtari Lef Nosi, për 80 vjet deri në jublieu njëqindvjeçar Dokumenti i Pavarësisë nuk doli kurrë në dritë i plotë, por vetëmse i censuruar kriminalisht. Edhe më e tmerrshmja: në vitin jubilar të njëqindttë promovohet me bujë fotografia "origjinale" e Dokumentit të shpalljes së Pavarësisë që edhe sot kësisoj njihet në opinionin e gjerë të të pavarurve e botime të gjithfarshme dhe s'i është bërë asnjë kritikë atij "origjinali" i publikuar me një Eureka të fortë dhe është pamja më e kriminalizuar e Dokumentit të shpalljes së Pavarësisë- i censuruar, i zhbërë, i mistifikuar, paçka se fotografia "origjinale", me mjeshtëri mafjose, mban nënëshkrimin Marubi (e botuar në një album për të) dhe e di që nga pakkush besohet, por mjerisht është e vërtetë e pamëshirë!


Dhe dihet se kërkimi i të vërtetës historike, veçanërisht për Dokumentin e Pavarësisë, është një punë tepër e vështirë dhe në këtë kërkim historik motivohem dhe nga një refleksion i Çehovit në novela Jeta ime: "Asgjë nuk kalon pa lënë gjurmë." (që është me vlerë kërkimore e në histori), më së pari është kërkimi arkivor, por më dukej se ai ishte shterur nga "gërmimet" ngulmuese të historianes Nevila Nika, ish-drejtoresha e Arkivit, por kisha dhe një tjetër arsye frenuese: Dokumenti në Arkiv s'do mund t'i shpëtonte syrit të riut kërkimtar e pasionant në histori, Kristo Frashëri, për një kohë me detyrë të veçantë arkivore në Arkivi shtetëror i sapo formuar, nga ish-drejtori i tij Zef Mala, ndaj dhe "teknologjia" ime e kërkimit orientohej në kërkime në Bibliotekën Kombëtare (plus biblioteka vetiake të koleksionistëve)- në qindra burime e referime në periodikë e botime të historisë në shqip por dhe në albanologji (mbeti pa u konsultuar libri në rumanisht: "Dhjetë vjet Shqipni" (1912-1922), i botuar në Konstancë (1922), i ekspozuar në Ekspozita Rilindja Kombëtare (1937) e i pandodhur në Bibliotekën Kombëtare, që mund të ketë informacione interesante, ndoshta autor mund të jetë Dhimitër Berati), për një periudhë mëse shtatëdhjetvjeçare, nga dhjetori 1912 e më pas, në gjetje të gjurmëve të Dokumentit dhe zbulim nyje informacioni për të ardhur tek e vërteta; në kërkim i orientuar e nga sentenca të vyera historike të Plutarkut e Demokritit: Detajet bëjnë historinë, apo e vërteta e madhe fshihet edhe mes rreshtash apo mes fjalësh në rreshta, apo kur mungojnë faktet vër në punë argumentin, arsyen. E kësisoj munda të rrok ca të vërteta të vlera për dokumentin historik të pavarësimit kombëtar.

EUREKA!

Po, Eureka! E pabesueshme, amá e vërtetë e pamëshirë: Për herë të parë vjen imazhi/fotografia e dokumentit të Pavarësisë, ashtu siç s'është parë ndonjëherë kurrë më parë dhe ja vjen si në ditën kur Ai shkruhej për herë të parë, atë 28 Nëntor 1912, me të veçantën se në trup ka "plagë" të shumta, porqë asesi s'ia ulin vlerën historike. [Figura 1] Me bindje, se ky imazh që vjen këtu është shkëputur nga Akti origjinal i Pavarësisë që ruhej e publikohej për herë të parë nga firmëtari Lef Nosi, dokument aq shumë i kërkuar në vitin jubilar. E shihet si merr jetë dituria çehoviane se "Asgjë nuk kalon pa lënë gjurmë." E jo vetëm...

Imazhi origjinal i Aktit të Pavarësisë ishte një gjetje që feksi kënaqësi intelektuale të veçantë me klithmën Eureka (proverbiale nga historia e famshme e saj.) Fotografia e Aktit është sa 1/3 e parë e dokumentit historik. Imazhi është për merita të historianit, Profesor Kristo Frashëri, që e kërkoi, e ruajti dhe e botoi në 45 vjetori i Pavarësisë në broshurën e tij "Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë", botim i Ministrisë së Kulturës, më 1957. E siç shihet, mjerisht dokumenti mbeti në kushte jo normale, në kontakt me lagështirën, pluhurin, e mbulon gjithandej myku. Dokumenti i Pavarësisë, siç është në imazh, paragrafi i parë i vendimit në shqip dhe i dyti i në osmanisht, kurse rreshti i parë i firmëtarëve fillon me Ismail Qemalin për të vijuar me pesë firmëtarë të tjerë, ku dhe ndërpritet vijimi i firmëtarëve. Imazhi/fotografia e Aktit të Pavarësisë është pasqyrim i drejtpërdrejtë, është pasqyrë e origjinalit të dokumentit të Pavarësisë dhe kjo e vërtetë e dallon atë nga dokumenti i botuar nga Lef Nosi, që vërtet ai është i pazevendësueshëm, amá është jo pasqyrim i drejtpërdrejtë i origjinalit por është imazhi i ripunuar i imazhit të Aktit e që thuajse saktësisht është njësh me dokumentin origjinal, në ruajtje prej Tij. Dhe kjo është rëndësia e vlera historike e pazevendësueshme e këtij fragmenti të Aktit të Pavarësisë, natyrisht në mungesë të dokumentit origjinal. Fragmenti i botuar këtu s'është një letër çfardo, është pjesë e dokumentit origjinal që kishte Lef Nosi apo e atyre disa-pak ekzemplarë të prodhuar të Dokumentit të Pavarësisë në ditët e para pas shpalljes së Pavarësisë. Historiani, në broshurën e tij reflekton qëndrim disi të akullt me dokumentin, s'ka as më të voglin koment për të apo gjetjen e tij, po kështu i harruar është dhe në libri i tij Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (2008), madje dokumentin e pavarësisë e jep në një pamje tjetër (katër firmëtarë të censuruar), kurse në dy intervistat, atë të gushtit dhe atë të nëntorit 2012 historian Frashëri është me një gjetje tjetër, herë-herë i dhimbsur për mungesën e dokumentit origjinal, rrëfen dhe "historinë" e dokumentit, por që refuzon të tregojë emrin e atij që e ka atë, siç edhe jepen hollësi në vijim. Imazhi i gjymtuar i dokumentit ndoshta do të plotësohet nga historiani me botimin e plotë të dokumentit prej tij e që do rritë shumë e më shumë vlerën e rëndësinë e dokumentit historik, por edhe të ëndërrojmë: Dokumenti, ai origjinali, nga është shkëputur fragmenti i botuar më1957, një ditë të afërt të zerë vendin më të nderuar në Muzeu Historik Kombëtar, amá për të dyja dëshirat jam shpresëdjegur. Dokumenti është pronë e 43 shpirtrave





Faksimile e Imazhi nga origjinali i Aktit të Pavarësisë/ fragment.

firmëtarë e
ia bënë Atë dhuratë kombit dhe kompromiset në histori për të vrarë të vërtetën janë krim i papranueshme. Si përfundim, përveçse Dokumentit të Pvarësisë në ruajtje e botim nga Lef Nosi, që jo vetëm si vlerë historike por edhe si konceptim është i pazevendësueshëm, tashti kemi dhe një dokument më shumë për ngjarjen historike: një fragment të rëndësishëm, fotografi origjinale e munguar deri tani e dokumentit origjinal të 28 Nëntorit 1912 dhe diç më shumë: po ashtu, shumë i ndjellamirë është edhe Dokumenti i Shpalljes së Pavarësisë në imazhin e dokumentit origjinal të kësaj date historike që na vjen nga albanologu Nexhip P. Alpan.

E vërteta është më e hidhur se diagnoza vdekëtare për pacientin!

Imazhi është për merita të historianit, Profesor Kristo Frashëri, që e kërkoi, e ruajti dhe e botoi në 45 vjetori i Pavarësisë në broshurën e tij "Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë", botim i Ministrisë së Kulturës, më 1957…

ZBULESA DHE PRURJA E RE NË HISTORI

Një kërkim i mundimshëm në gjurmë të Aktit të Pavarësisë dhe vjen ai çast lumturimi intelektual, amá në meritë të kërkimit të gjatë të albanologut shqiptaro-turk Prof. Necip P. Alpan që shtie në dorë dokumentin historik të pavarësimit të Shqipërisë dhe e boton në turqishte të re në libri i tij "Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe vlonjati Ismail Qemali" (1982), po ashtu edhe në meritë të shqiptaro-amerikanit të njohur Ekerem Bardha që librat e Necip Alpan i dhurohen Bibliotekës Kombëtare në Tiranë; dhe pa pikë dyshimi dokumenti i zbuluar prej Alpan, që vjen këtu është njësh me origjinalin, plotëson e saktëson e ndonjë paqartësi, pasaktësi e mangësi fare të vogla po të qënësishme të dokumentit të botuar nga Lef Nosi, në 25-vjetorin e Pavarësisë, më 28 nëntor 1937.

Nexhip P. Alpan, i lindur në Zhulat të Gjirokastrës (më 1920) e prej atëherë familjarisht emigrant ekonomik në Turqi dhe tërë jetën atje deri kur ndahet nga jeta, me 2003. Prof. Alpan, me arsim universitar, autor i më shumë se 30 librave studimore e me të vetmin subjekt: shqiptaria- histori, kulturë, arsim, figura të shquara me origjinë shqiptare e mes tyre monografia për Ata Turkun, me qindra artikuj e studime në gazeta e revista turke e të huaja, la të përfunduar një fjalor Turqisht-Shqip me 5000 fjalë, i vënë në proces botimi. Biblioteka personale e tij ka më shumë se 6000 tituj libra shumëgjuhëshe, por edhe me dorëshkrime të shumta të vjetra disa gjuhëshe me temë shqiptarët. Me marrëdhënie akull me ambasadën shqiptare të atjeshëm por në dhjetëvjeçarin e fundit i rrethuar me kujdes të veçantë prej saj. Nderimi i merituar i Necip Alpan është nderim për Atdheun.

Në vitin e 62-të të shpalljes së Pavarësisë, Necip P. Alpan botoi librin "Arnavutlugun Bagimsizligi v e Avlonyali Ismail Kemal" (Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë…). Libri ka një bibliografi të pasur disagjuhëshe, padyshim me burime në shqip e një prej tyre kishte dokumentin e Pavarësisë të censuruar harbutçe! Në f. 24 të librit, autori në një faqe të plotë boton faksimile/ fotografi me emërtesë në kapitale shqip në të zezë: "DOKUMENTI I SHPALLJES S□ PAVAR□SIS□" dhe përfundi dokumentit katër rreshta në turqisht: "Me shkronja të vjetra [osmanishte, vb] shkruhet atje kështu: "Ismail Qemal Beu, Kryetar i Kongresit [Kuvendit] deklaroi rreziqet e mjerimet ku ndodhej Shqipëria dhe Kongresistët pranuan me një zá Independencën dhe proklamuan Shqipërinë Shtet Independent e të lirë." Dokumenti i shpalljes së Pavarësisë në libër është disi flu, por puna me merak e standard profesional e dizajnerit të njohur Petraq Papa na afron atë pamje joshëse të sakt të dokumentit, si mbrëmjen e 28 Nëntorit 1912, kur nënëshkruhej dokumenti historik. [Figura 2] Meraku për t'u lidhur me familjarë të autorit për më shumë hollësi për dokumentin për arsye objektive mbeti i pazëshëm: djali, një profesor i shquar ekonomie në USA i ndarë nga jeta.

Skënderbeu në hetim për trukim: 5-10 mln Euro

Federbet: Ndeshja me Sportingun dyshohet e fiksuar në kompanitë aziatike të basteve

Lajm zhgënjyes dhe trondítës për futbollin shqiptar, Skënderbeu akuzohet nga Federbet për trukim të ndeshjes përballë ekipit të Sportingut të Lisbonës. Në kulmin e suksesit për arritjet rekord këtë edicion në kupat e Europës që po mbyllet me pjesëmarrjen, pasi pikë vështirë që do të marrë, Skënderbeu është vendosur në shënjestër për manipulimin e sfidës përballë portugezëve, të cilën e humbi me rezultatin e thellë 5-1. E ndërsa kampionët e Shqipërisë i vendosën 'kapak' humbjes së thellë dhe historisë së Lisbonës, e kundërta ndodh me organet hetuese të UEFA që monitorojnë lëvizjen e koeficentëve live gjatë zhvillimit të ndeshjes. Kompania për të kontrolluar dhe hetuar bastet, "Federbet", nëpërmjet një njoftimi të fundit për shtyp e ka konsideruar ndeshjen e Ligës së Europës, Sporting Lisbona-Skënderbeu 5-1 si të dyshuar për trukim. Sipas Federbet në kompanitë e basteve në Azi mund të jenë luajtur 5-10 milionë Euro për ndeshjen e Europa League të Skënderbeut me Sportingun. "Federbet konsideron se ndeshja e futbollit, Sporting Lisbona-Skënderbeu, e luajtur më 22 tetor 2015 (e vlefshme për fazën në grupe të Ligës së Europës), dyshohet si e fiksuar. Një ekip që ka pak pretendime për të kaluar grupin është më shumë i predispozuar për të trukuar. Për takimin Sporting-Skënderbeu në Azi mund të jenë luajtur 5-10 mln Euro"thotë Francesco Baranca, sekretari i përgjithshëm i "Federbet". Ndërsa UEFA është shprehur se "Kemi nevojë për më shumë se statistika për të dënuar një ekip për trukim". Kjo nuk është hera e parë që Skënderbeu akuzohet për trukim ndeshjesh në Europë, pasi edhe më parë në ndeshjet miqësore, por edhe në fazën e Champions League në muajin Korrik në ndeshjen përballë Crusaders, por edhe Dinamos së Zagrebit, korçarët u akuzuan për fiksim të rezultatit. Deri tani nuk ka asnjë reagim nga klubi korcar për akuzat e ngritura. Ndërsa ende nuk dihet se si do të veprojë UEFA për rastin në fjalë, pasi rrezikon që të përjashtohet nëse do të gjendet fajtor për raportin e publikuar nga Federbet, teksa kujtojmë që pak kohë më parë Fenerbace në Turqi u përjashtua.



RAPORTI

"Anomalia në rrjedhën e basteve për ndeshjen Sporting-Skënderbeu ka filluar gjatë lojës "live" dhe në veçanti në pjesën e dytë"thuhet në raportin e Federbet për ndeshjen.

BALLISTI

Mungon avokati shtyhet seanca në apel për Ismail Morinën



Shtyhet seanca, Apeli vendos të premten për fatin e Ballist Morinës. Ismail Morina, i arrestuar i arrestuar prej 3 javësh për armëmbajtje pa leje do të mësojë më 30 tetor, nëse do të vijojë të qëndrojë në burg apo do të fitojë lirinë. Seanca e djeshme në Gjykatën e Apelit u shty pasi mungoi avokati i Morinës, Ardian Visha. Morina, i njohur edhe si "Ballisti", u arrestua më 7 tetor në Tiranë, gjysmë ore pas mesnate, pasi u kap nga policia me dy pistoleta, një në brez dhe një në makinën me të cilën udhëtonte. Arrestimi i tij erdhi vetëm një ditë para ndeshjes Shqipërisë-Serbi që u luajt në "Elbasan Arena". Për këtë ndeshje, Ballisti kishte mundur të siguronte biletën për ta parë në stadium.

PREZANTIMI

Tirana zyrtarizon Dajën, Disiplina 'masakron' Tepelenën

Më në fund edhe zyrtarisht Tirana është me trajner të ri, teksa gjatë mesditës së djeshme klubi ka prezantuar Ilir Dajën si pasuesin e Mucës, që u largua pas barazimit me Flamurtarin dy javë më parë. Pasi u shpall kampion me Elbasanin dhe me Dinamon, Daja do të kërkojë që të përsërisë suksesin edhe me ekipin e Tiranës edhe pse do të jetë shumë e vështirë duke parë gjendjen në të cilën ndodhet tani dhe nivelin e kundërshtarëve që po ecin me ritëm të lartë. Megjithatë Daja ka ulur pritshmëritë duke deklaruar se nuk ka shkopin magjik për të ndryshuar gjërat përnjëherë duke kërkuar kohë dhe mbështetje. "Do ta menaxhoj ekipin sipas ideve që kam në kokë, si mënyrë që të mbroj edhe investimet e presidentit Halili. Personalisht do të jap maksimumin për të rikuperuar pikët e humbura, por nuk kam shkopin magjik. Në këto pak ditë të mbetura përpara ndeshjes me Kukësin do të bëjmë maksimumin për të arritur më të mirën. Do të nevojiten të paktën 5-6 javë punë që skuadra të arrijë në kondicionine duhur fizik. Me presidentin Halili do të afrojmë edhe një përgatitës të aftë atletik, një element shumë i rëndësishëm"tha ai. Ndërsa Komisioni i Disiplinës në FSHF ka dënuar ekipet e Partizanit me 200 mijë lekë dhe Skënderbeut 500 mijë lekë për sjelljen e tifozëve, ndërsa Vllazninë 50.000 mijë lekë. Ndërsa Tepelena ka humbur ndeshjen në tavolinë dhe detyrohet që të zhvillojë 4 ndeshje pa tifozë pas incidenteve përballë Naftëtarit ku u dhunua arbitri. Lojtarët e Tepelenës Pashun Halo dhe Roland Gaba për goditje me grusht të zyrtarit të ndeshjes dënohen respektivisht me nga 12 dhe 24 muaj pezullim



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- 'Arena Kombëtare' zbardhet plani i stadiumit të ri që do të ndërtohet
- Hisku: Pse s'më mbronte dot Dritëro Agolli kur më burgosën
- FOTO/ Çfarë i ka bërë vetes Messua, e bija e Maharaxhait?!
- Kapet 1 ton drogë, vëllezërit nga Shijaku 'kapo' të trafikut në Itali
- Zbrit nga karrigia e kryeministrit shih si e katandise vendin /LETRA
- 'Kaubojsi' Eduard Ndocaj nesër në Kuvend me makinën e 'Il padrino'
- Alida Hisku: Si na përdhunonin prokurorët e sigurimsat në qeli
- Behgjet Pacolli zbulon Albaninë Kaukaziane / FOTO e tempullit
- Ndocaj drejt Parlamentit, 'kaubojsi' pritet në Rinas me kalë të bardhë
- E mbijetuara e kancerit tregon fotot e dhimbshme: Kjo është e vërteta

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- 'Arena Kombëtare' zbardhet plani i stadiumit të ri që do të ndërtohet
- Hisku: Pse s'më mbronte dot Dritëro Agolli kur më burgosën
- "Laguna Blu", Artan Lame: Akti i shitjes së tokës është kriminal
- Ndocaj drejt Parlamentit, 'kaubojsi' pritet në Rinas me kalë të bardhë
- I tha "gjobaxhi", ish-kryeministri Berisha fiton gjyqin me Filip Çakulin

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

"Kuponi tatimor", Majko: Në vend të shoferit të mos dënojmë pronarin

Kapet 1 ton drogë, vëllezërit nga Shijaku 'kapo' të trafikut në Itali

QSUT, pacientët kurohen në korridore të spitalit, Vargu: Të lirë për gjykim

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

SONDAZHI I DITES

Jeni dakord me projektin e Qeverisë që parashikon burg për evazorët?

Rezultati i Sondazhit

Po 49.75%

Jo 45.27%

Disi 4.98%

SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë

1,570 KOMENTET E DJESHME | 223.908 TOTALI LIKE

Cyan magenta yellow black

PARADË

FJALËKRYQESH



NGA **Kadri Vokopola**

FJALËKRYQI **PA SKEMË**

DUHET TË NXINI **33** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

1. Janë në vit të fundit të gjimanzit të tillë.
-Janë shtëpi.
2. Është sëmundja e atij që refuzon të hajë nga frika se shëndoshet.
-Gjysma e vaskës.
-Në kryq të komandës.
3. Fillojnë lejen.
-Inicialet e Delon.
-Është regjistër tokash.
4. Një kampion i metrit.
-Është dyqan me çanta e dorashka
5. Gjysma e sallës.
-Qe gruaja e famshme e Akenatonit.
6. Një shtet aziatik.
-Janë kundërshtarë të idealistëve.
7. Filozofi me eksperimentin e gomarit
-Ekstreme në motel.
-Inicialet e Morata-s.
8. Paguhet për vonesë.
-Ente Autonome.
-Inicialet e Einstein.
-Gjymsë kritik.
9. Di të presë mish.
-Ruhet në fund.
-Gjysmë arrest.
-Pak likantropi.
10. Janë tek në natyrë
-Është sportiv ai i Alban Xhihanit.
-Qe perëndesha e fitores
11. Është stratagjemë, dredhi.
-Janë mallkime.
12. Vala e stadiumit
-Mund të jenë liberty dhe barok.
-Shteti i francezëve.

VERTIKAKL

1. Është e Madhe në Koplik
-Fillojnë motivin.
2. Është ai që ka aderuar në parti.
-Një mund të jetë vaditës
3. Fillojnë torturat
-Është gur zbukurimi.
4. Lumë në Rusi
-Është bixhoz
5. Odilon piktor.
-Muzika e Eminem.
-Inicialet e Sinatra-s.
6. Fillojën aktivitetin
-Janë legjendare.
7. Nesër pa zanore.
-Këndon Ma che freddo fa.
-Votim pa ekstreme.
8. Fillojnë titrat.
-Janë çorapet e futbollistëve.
-Nolde që qe piktor.
9. Janë lokale me macchiato.
10. Këndohet nga Elsa Lila.
-... King Cole.
11. Është për të zbuluar avionë.
-Agjenci Transporti Ndërtimi
12. Një karavelë e kolombit.
13. Ben aktor.
-Fillojnë termën.
14. Është tetëshe këngëtarësh
-Rrjetë në tenis.
15. Chuck aktor
-Është e shëndetshme ajo malore
16. Fundi i një samurai.
-Një sekt islamik.
17. Fillojnë kalimin.
-Janë të zbehtë.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

S	L	O	■	E	P	L	O	T	E	■	K	■	D	P	■	A
H	O	V	■	D	E	T	■	S	■	B	A	M	I	R	E	S
A	L	A	M	E	T	■	D	■	L	A	M	E	■	O	N	I
K	I	L	O	N	I	■	A	M	A	L	A	S	U	N	T	A
A	T	■	D	■	T	A	M	A	T	E	T	E	■	A	I	■
T	A	P	E	T	■	K	A	P	I	T	A	L	E	T	■	F
E	■	L	R	■	M	A	R	O	N	I	T	E	T	■	T	E
■	C	A	N	D	I	D	E	■	I	■	■	T	E	M	A	T
M	A	N	E	T	■	E	■	O	S	■	M	E	R	I	T	A
O	R	E	T	■	S	M	I	T	H	■	E	■	■	S	I	R
D	O	T	■	P	R	I	V	A	T	E	■	P	O	H	■	E
A	L	I	E	N	S	■	A	R	■	B	L	E	R	I	O	T

FJALËKRYQI **SPORTIV**






HORIZONTAL

1. Një Hamdi bomber
5. Në hyrje të sallës.
7. Kufizojnë dënimet.
9. Traineri te Roma.
13. Ekstreme në guxim.
15. Një pjesë orkestrale.
16. Personazhi në foto.
22. Personazhi në foto.
24. Një ekip... anglez.
26. Janë titujt në ekran
27. Roberto Baggio.
28. Qendër kurimi.
29. Federer tenist.
32. Reus bomber.
36. Müller bomber gjerman.
38. Mbahet për linjën.
40. Fillojnë radhën.
41. Është veshje sportive.
42. Radiotelevizioni i Kosovës.
43. Gjysmë nderim.
44. Pogba te Juventus.
45. Josa trainer (inic).
46. Oliver Stone.

VERTIKAL

1. Kështu fillon sporti
2. Ekstreme në harar.
3. Fundi i një fatziu.
4. As unë as ti
5. Sapo fillojnë.
6. Fare pa fe.
7. Një pjesë e direktivës.
8. Është ndeshje.
10. Është për të korrur.
11. Buffon portier.
12. Ashley mbrojtës anglez.
13. Mund të shënohet e kokë.
14. Parashtesë për shumë vitamina.
16. Është anonime pa emër.
17. Banka e Vatikanit.
18. Një grand për tenistë.
19. Në fillim të vitit.
20. Inicialet e Paganini-t.
21. Agjenci Transporti Berat.
22. Cáceres te Juventus.
23. Njëmbëdhjetëmetërsh për Totti-n.
25. Në krye të armatës
30. Oliver Hardy.
31. Andrea aktore.
33. Smith filozof.
34. Një pjesë e ceremonisë.
35. Rehhagel trainer.
37. Mish pa kocka.
39. Një bosht.
41. Fillojnë turnin.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



■	■	■	K	A	R	A	T	E	■	S	E	T	■	■	R	O
■	■	■	A	L	■	■	A	■	■	U	T	R	E	C	H	T
■	■	■	■	B	E	C	K	E	N	B	A	U	E	R	■	T
■	■	■	G	■	S	H	A	L	A	■	P	■	■	■	S	O
■	N	I	C	O	L	E	■	■	S	K	U	A	D	R	A	T
■	V	O	■	O	L	A	■	■	B	A	■	S	T	R	I	K	E
■	O	T	■	M	A	R	K	O	■	■	■	A	■	■	■	■	■
■	R	E	J	A	■	■	■	O	■	E	R	A	■	E	E	■	■
■	F	R	A	N	C	K	R	I	B	E	R	Y	■	L	■	■	■
■	I	I	■	■	E	R	I	K	L	A	M	E	L	A	■	■	■



SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

8		7		3		2		4
		3	9		4	7		
4	9		5	2	7		6	3
	8	2				6	4	
9		4				5		7
	7	5				1	2	
2	1		7	5	3		8	6
		8	4		2	9		
7		6		9		3		2

PËRGJIGJE

2	4	3	1	9	7	5	8	6
9	5	1	3	8	6	7	2	4
7	8	6	2	4	5	3	1	9
8	3	5	9	7	2	4	6	1
4	1	2	6	3	8	9	7	5
6	7	9	4	5	1	8	3	2
1	9	4	8	2	3	6	5	7
3	2	7	5	6	9	1	4	8
5	6	8	7	1	4	2	9	3

HOROSKOPI

DASHI

Jeta juaj ne çift do jete me e kënaqshme dhe me e ndritur se me pare. Ne çdo moment do përjetoni emocione te papërsëritshme. Beqaret do realizojnë takime pa fund, por ne fund nuk do jene gati te hedhin hapa me tej. Druajtja do ju lere vetëm për një kohe te gjate. Ne planin financiar fati do jete ne anën tuaj. Do i kryeni pa frike shpenzimet e domosdoshme.

DEMI

Do keni besim te verbër tek partneri juaj sot dhe me te do pranoni te shkoni kudo e te bëni gjithçka. Ai nuk ka për t'iu zhgënjyer asnjë çast. Beqaret do kenë ndryshime te mëdha ne jetën sentimentale. Princi i kaltër do shfaqet papritur. Nëse doni qe buxheti te përmirësohet sa me shpejt duhet te nënshkruani kontratat e punës qe iu janë propozuar.

BINJAKËT

Tregohuni sa me te kuptueshëm dhe te dashur me partnerin sot sepse vetëm ne këtë mënyrë do arrini ta përmirësoni marrëdhënien. Me kokëfortësi dhe inat nuk keni për te fituar asgjë. Beqaret nuk do jene ne qejf dhe do mbyllen ne vetvete. Financat here do jene te mira dhe here goxha problematike. Hiqni dore nga shpenzimet e pamenduara.

GAFORRJA

Jupiteri do jete planeti qe do ju siguroje një jete te qëndrueshme ne çift. Do dashuroheni pa dorashka dhe gjithçka do ju ece ashtu si keni ëndërruar. Beqaret do jene me më shume fat se me pare dhe do arrijnë ta bëjnë për vete personin qe pëlqejnë. Financat do kenë përmirësime te njëpasnjëshme për shkak te një shume parash qe do merrni nga trashëgimia.

LUANI

Mos luani me ndjenjat e partnerit tuaj gjate kësaj dite sepse me vone keni për t'u përballur edhe ju me vuajtjen. Nuk do vleje as pendimi. Beqaret do realizojnë takime elektrizuese te cilat me shume gjase do ua ndryshojnë përgjithmonë jetën. Me financat tregohuni te organizuar dhe te arsyeshëm sepse ne te kundërt keni për te pasur probleme serioze.

VIRGJËRESHA

Rutina do mbizotërojë gjate gjithë ditës sot ne jetën tuaj ne çift. Here pas here mund te ndiheni keq sepse me te vërtetë do keni nevoje për diçka ndryshe. Beqaret nuk duhet te besojnë ne dashuri me shikim te pare sepse personat qe do mundohen t'i joshin janë intrigues. Ne planin financiar do i zgjidhni shpejt problemet qe ju kishin dale dhe do jeni me te qete.

PESHORJA

Dite tejet e paqëndrueshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do kërkoni gjera te ndryshme nga partneri dhe nuk do bini dakord për asgjë. Beqaret sado qe te mundohen do e kenë te vështirë ta afrojnë pas vetes një person qe pëlqejnë. Ne planin financiar gjerat do ecin me se miri. Do ndiheni te qete edhe kur te bëni ndonjë shpenzim me tepër se zakonisht.

AKREPI

Dite shume e trazuar dhe e mbushur me mosmarrëveshje te njëpasnjëshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Kujdes me çdo hap qe do hidhni. Beqaret fatmirësisht do kenë një dite shume me ndryshe. Mund te fillojnë edhe lidhje pasionante. Ne planin financiar nuk duhet kurrsesi te nxitoheni sepse po filluan problemet nuk do kenë te reshtur.

SHIGJETARI

Dite e qete dhe pa asnjë problem do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Me partnerin do merreni vesh edhe me shikime. Beqaret do bëjnë mire te mos ndërmarrin rreziqe te ekzagjeruara vetëm për te ndryshuar statusin. Ne planin financiar priten vështirësi te mëdha, por me pak ndihme nga familjaret dhe me pak maturi do ja dilni mbanë.

BRICJAPI

Nuk do keni mosmarrëveshje ne çift gjate kësaj dite, megjithatë as nuk do përjetoni emocionet qe gjithmonë keni dashur. Për çdo gjë flisni hapur me partnerin. Beqaret nuk do jene ne humor te mire për te dale e për t'u njohur me persona te rinj prandaj do mbeten ende vetëm. Buxhetin do e keni me tepër ne kontroll dhe nuk do ketë asnjë tronditje.

UJORI

Sot do ketë ndryshime radikale për ata qe janë ne një lidhje. Përgatituni shpirtërisht sepse as ne ëndërr nuk i kishit menduar gjerat kështu. Rëndësi ka qe kënaqësitë do jene te paimagjinueshme. Beqaret do vazhdojnë ende te jene ne kërkim te princit te kaltër, por fatkeqësisht pa fat. Ne planin financiar nuk priten tronditje te mëdha, thjesht ulni shpenzimet.

PESHQIT

Ka shume mundësi qe sot partneri juaj t'i pranoje gabimet e bëra dhe te beje atë qe thoni ju. Mbrëmja ka për te qene emocionuese. Beqaret do kenë goxha probleme profesionale dhe nuk do kenë kohe te mendojnë për jetën sentimentale. Ne planin financiar do jeni te matur dhe këmbëngulës për te ruajtur gjendjen te qëndrueshme. Do i kaloni vështirësitë.

PËRGJIGJE

A	Z	I	L	■	B	■	M	R	■	D	E	F
S	A	B	O	T	I	M	I	■	A	U	T	O
I	T	■	P	A	R	A	D	A	T	■	■	R
A	■	T	A	R	I	K	A	T	I	■	K	U
■	F	I	T	I	L	I	■	L	■	S	U	M
■	S	K	A	F	A	N	D	E	R	■	B	E
B	■	■	T	A	T	A	■	T	A	V	A	T
A	Z	T	■	T	■	T	R	■	S	L	■	■
L	I	R	A	■	I	■	A	N	T	E	N	E
E	L	E	M	E	N	T	I	■	E	F	■	U
N	I	V	E	L	E	T	■	E	S	T	E	R
A	■	A	N	E	S	T	E	Z	I	A	■	O

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALEKRYQI **I KRIPTOGRAFUAR**

12G	6	9	■	■	5	10	■	15	8	1	5	6
3O	2	6	5	7	2	1	5	■	1	4	1	5
5T	■	4	3	5	6	2	1	5	■	5	4	2
6A	■	6	10	1	2	8	11	6	4	1	5	■
■	■	5	■	2	1	5	1	■	1	2	6	■
■	11	3	12	3	5	6	■	15	14	■	5	17
13	6	2	6	■	■	5	1	2	1	17	8	6
8	4	8	13	■	12	■	4	6	2	■	14	4
6	15	16	■	6	2	8	5	10	8	■	6	6
10	8	10	3	17	6	5	■	6	6	■	5	5
1	5	■	17	8	5	1	5	■	■	15	■	8
17	8	10	■	6	1	■	11	6	17	6	5	■

Alba Malltezi - **Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group** ; Brahim Shima, Aurel Pepa - ***Zv/kryeredaktor***
Genc Kondi- ***Administrator i Përgjithshëm*** ; Admirina Peçi- ***Kryeredaktore e "Rilindasi"*** ; ***Politika:*** Brahim Shima, ***Ekonomi :*** Lorenc Rabeta, ***Aktualitet:*** Elton Qyno,
Sociale: Sonila Isaku, ***Kulturë:*** Dhurata Hamzai, ***Sporti:*** Dylber Balla, ***Design:*** Altin Aliaj, Erjon Ymeri, ***Website:*** Greta Malaj, ***Shpërndarja:*** Spiro Meshini ***cel:*** +355696088847

Departamenti i Marketingut:
Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. ***E-mail:*** redaksia@shqiptarja.com - ***Website:*** www.shqiptarja.com - ***Mobile:*** +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

DY VJET JETOVA MES MALEVE SHQIPTARE E ITALISË

Laura Bispuri:

Kam lexuar Kanunin e Kadarenë për filmin "Burrnesha"

Filmi vë në dyshim lirinë e grave, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Itali. Ja pse Hana bën dashuri në banjën e një pishine


DHURATA HAMZAI
TIRANE

"Vergine Giurata"- "Virgjëreshat e betuara" është filmi im më i dashur, -është shprehur regjisorja Laura Bispuri, e cila ka debutuar në botën e filmit me "Passing Times", "Salve Regina", "Blonde", e disa dokumentarë. E pranishme dje për premierën e filmit në Tiranë, në kuadrin e Tirana Film Festival, Bispuri, ka folur gjatë për mënyrën si u krijua ky film. Kryesisht filmi "Burrnesha" me skenar të autoreve italiane, Laura Bispuri dhe Francesca Manieri e regji të Laura Bispurit është mbështetur mbi romanin e Elvira Dones "Hana". Në rolin kryesor luan aktorja italiane, Alba Rohrëacher, e cila në katër festivalet e fundit në Venecia ka fituar tri herë si aktorja më e mirë dhe në karrierën e saj numëron mbi 20 çmime ndërkombëtare. Në film luajnë aktorët shqiptarë Flonja Kodheli, Bruno Shllaku, si dhe dy vajza të reja nga Valbona e Tropojë, Drenica e Dajana Selimaj, si dhe aktorët kosovarë Luan Dautaj e Ilire Vinça Velaj.

Filmi prezantohet në shqip me titullin "Burrneshat", ashtu siç thirreshin në Shqipërinë e Veriut "virgjëreshat e betuara" që merrnin përsipër rolin e kryetarit të familjes në mungesë të një mashkulli në krye të saj. Kjo sakrificë e ka ngacmuar Laura Bispurin, kur lexoi librin e Elvira Dones që rrëfen historinë e këtyre burrneshave, dhe traditën që ka mbijetuar edhe sot në zona të thella të Veriut. Kjo temë bëhet një objekt simbolik për të shprehur humbjen e lirisë njerëzore. Megjithatë vendi ku xhirohet, Shqipëria, traditat e saj, deri tek "Gjama e Burrave", ruajnë karakterin unik të këtij vendi.

Filmi "Vergine Giurata", në shqip "Burrnesha" u dha dje paradite për median. Regjisorja Bispuri ka përdorur elementë konvecionalë për të lidhur pjesët e filmit. Hanën e shndërruar në Mark që jeton në Malet e Veriut, e zhvendos me evolucionin e shoqërisë dhe tashmë ajo është Marku që i duhet të shkojë në Itali pas vdekjes së nënës, për të gjetur motrën, që prej vitesh kishte krijuar familje me të dashurin, me të cilin ishte arratisur nga vendi i saj, pa i duruar dot zakonet ndrydhëse, si "femra s'ka të drejtë me e zgjedh vet burrin e saj", etj.

Rrëfimi i filmit të Laura Bispurit është diakronik, i përbërë nga kryqëzimi i dy lëvizjeve të kundërta. Pjesa e parë e filmit është vendosur në Shqipëri, ku regjisorja është fokusuar tek zgjedhja e Hanës për t'u bërë Marku, duke hequr dorë nga feminiliteti i saj, dhe pjesa tjetër zhvillohet në Itali për të rikompensuar humbjen e një të drejte njerëzore, mohimi i seksit. Pjesa e rilindjes së personazhit e shfaq gjithmonë e më tepër dramaticitetin e momentit të parë, kur kjo qenie njerëzore u betua të mos përjetonte ndjesitë e saj në emër të traditës, e kuptuara ndryshe në film edhe në emër të një ideali. Regjisorja thotë se është munduar të ketë një finale sa më harmonioze, por në film ka një pikëpyetje estetike, duke e parë nga kontekstestet e kulturës dhe psikologjisë shqiptare. A do të zgjidhte vallë një vajzë me ndjenja të ndrydhura dhe krenari ekstreme



që ta niste dashurinë e saj në një "shurrëtore" pishinash...?! Përveç kësaj pikëpyetje që rri pezull, në fakt Laura Bispuri ka sjellë përsosmërisht në kohë një temë arkaike si ajo e virgjëreshave të betuara, duke provokuar të sotmen ku gjinitë deformohen dhe shumë qenie ende nuk e kanë kuptuar nëse janë burra apo gra. Natyrisht, ajo një regjisore që lufton në industrinë e "egër" të filmit pohon se ky film "vë në dyshim" shkallën e lirisë së grave, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Itali.

Si mundët, ju zonja Bispuri, që ta kuptonit kodin e atyre zakoneve të lashta të Malësisë së Veriut, që edhe ne shqiptarët e kemi të vështirë t'i kuptojmë pa ndihmën e studiuesve ose etnologëve, siç janë "Gjama e burrave" apo traditat e tjera?

-Unë kam lexuar shumë, kam lexuar Kanunin, librat e Kadaresë dhe librin "Vigjëreshat e betuara". Për këto elementë ka shumë materiale, mjafton të kërkosh, siç është dokumentari i Elvira Dones dhe pastaj edhe libri "Hana" i saj, libri ku është bazuar filmi artistik. Kam lexuar intervistat e bëra me këto gra e me këto virgjëresha. Si fillim unë u mundova ta kuptoja në vetën e parë sesi mund të ishin ligjet e zakonet apo rregullat. Pastaj lidhja ime ka qenë, jo vetëm me vetë virgjëreshat, por me vendin ku jetonin ato dhe herë pas here kisha perceptime të ndryshme me mënyra të ndryshme dhe kontradiktore me idenë që kisha unë mbi këtë fenomen. Unë e sfidova kuptimin e këtij fenomeni, duke e kapërcyer edhe më tej. E kuptova pas kësaj se nuk është fenomeni apo rregullat që marrin rëndësi, por është edhe forca e personave që e çon më tej këtë fenomen. Për mua përtej fenomenit janë njerëzit. Secila prej virgjëreshave ka botën e saj, ka pasiguritë e ndryshme. Kam dashur t'i përmbledh të gjitha këto kultura njohjeje, që t'i fus brenda personazhit, se sigurisht unë do të tregoj historinë e njërës prej tyre. Pasi lexova ligjet e Kanunit, zbulova se femra fiton të njëjtat të drejta me burrat, sapo heq dorë nga marrëdhëniet e saj si femër dhe betohet për paprekshmërinë e turpit. Ndërsa shkruaja skenarin me Francesca Manierin për dy vjet, unë kam qëndruar mes Italisë dhe Shqipërisë, duke u kthyer në malet shqiptare, duke biseduar me malësorët shqiptarë, iu rrëfeja skenarin me të cilin punoja për xhirimet e këtij filmi. Në Shqipëri unë kam hulumtuar në trashëgiminë e lashtë të këtij vendi, kam studiuar ligjet e një shoqërie që ruan ende disa zakone fisnore dhe ky film erdhi si një zbulim.

Mesazhet përtej subjektit të këtij filmi cilat janë?

-Mesazhet janë brenda nesh, brenda kohës në të cilën jetojmë. Koha ku jetojmë vuan nga disa probleme, që ende unë vetë, ne gratë po i përjetojmë, ne ende nuk e kemi arritur shkallën e lirisë që duhet të kemi sot si qenie njerëzore dhe si gra. Kur nisa xhirimet kuptova se kjo temë më përkiste mua. Gratë nuk e kanë arritur shkallën e duhur të lirisë, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Itali. Xhirimet kanë pasur shumë vështirësi, por të gjitha u zgjidhën si me magji. Kujtoj sesa e vështirë ka qenë për mua që të gjeja dy vajzat adoleshente që të luanin Hanën dhe motrën e saj, Lilën, sepse aktoret kryesore në pjesën më të madhe të filmit janë në moshën madhore. Jam befasuar me zbulimin e dy vajzave nga Tropoja. I pashë dy motrat, Drenicën dhe Dajanën, në Valbonë, që rrinin e vështronin të mbështetura në portën para shtëpisë së tyre. M'u desh të sigurohesha se ishin pikërisht ato, dhe sidomos për Drenicën që i ngjante aq shumë Albës. Kur u ktheva të bisedoja i gjeta në të njëjtin pozicion. Dukej sikur më kishin pritur mua. Një vështirësi tjetër ishte se xhirimet na u vonuan deri në prill dhe duhej të binte borë për filmin. Dhe ja një ditë të bukur bora filloi. Shkrepa kamerat. Më shumë kuptim kishte edhe vaji i burrave për babain e Hanës në mes të dëborës. Kam xhiruar nga afër, pa i gjykuar malësorët, por duke respektuar traditat e tyre, vendin e tyre. Më tej me ikjen e Markut nga Shqipëria i vendos ngjarjet në një pishinë. Marrëdhëniet e Mark-Hana me kujdestarin e pishinës shfaqin peisazhin italian, ku dua të nënkuptoj se realiteti bashkëkohor i zhduk barrierat në mes të popujve, e këtë dua ta jap në një mënyrë delikate. Çdo gjë që ne shohim është pasqyrim i botës së brendshme të Markut. Marku, duke rizbuluar identitetin e tij femëror, Hanën, do të përfaqësojë deri në fund të filmit realitetin e shprehjes së lirisë njerëzore.

E parë në këndvështrimin tonë si shqiptar, nuk duket aq i gjetur vendi ku Hana nis dashurinë, banja e një pishine, nuk e motivon krenarinë e saj...

-Jam munduar të mos bëjë një skenë false.

BURRNESHA

Unë e sfidova kuptimin e këtij fenomeni, duke e kapërcyer edhe më tej. E kuptova pas kësaj se nuk është femomeni apo rregullat që marrin rëndësi, por është edhe forca e personave që e çon më tej këtë femomen. Për mua përtej femomenit janë njerëzit.



NË FOTO: Regjisorja Laura Bispuri, *(poshtë)* Aktoret e reja nga Tropoja, Drenica dhe Dajana Selimaj, që luajnë te "Burrnesha", dje pas premierës në Tiranë

Cyan magenta yellow black